

854-32-93

N 36



NË AKSION

894-32-93

N 36

BIBLIOTEKA E RINISË

25

NË AKSION

(TREGIME DHE DITARE)

28/3/55

28/3/55

~~BIBLIOTEKA E SUELEDE~~
~~GJENOCIDITËR~~

SHTËPIA BOTONJSE «NAIM FRASHËRI

NË AKSION


U zgjova e trembur nga goditjet e çangës. Ç'goditje të forta! Hapa sytë në errësirë dhe hodha vështrimin nga dritarja për të shquar ndonjë rreze drite. Sa shpejt po na zgjojnë, mendova. Dëgjova zëra të shqetësuar në oborr. Fjala — zjarr dëgjohej dendur. Më kaluan të rënqethura në trup. Në kapanonin e djemve dëgjohej zëri i komandantit të brigadës. Po zgjonte djemtë. Tek ne ende s'po vinte njeri. Vajzat flinin, nuk kishin dëgjuar asgjë. «E qartë, diku duhet të ketë rënë zjarri», mendova. U ngrita dhe u thirra vajzave. Ato s'më dëgjuan. U thirra prapë.

— Ç'është? pyeti përgjumshëm Rabia.

— Ka rënë zjarr, — fola unë. — Po shkojnë të gjithë ta shuajnë.

Pas pak u zgjua edhe Lola. Vajzat e tjera u zgjuan më vonë. Po visheshin në errësirë. Kapanoni i djemve gjëmonte nga zérat. Në oborr buçiste motori i maqinës. Duhet të ishte Marku me «Zisin» e tij. Dëgjohej i mbetur zëri i komandantit: — Shpejt, djema, shpejt, nuk pret koha!

Ne ishim gati. Rabia dhe Lola dualën të parat në oborr. Pastaj dhe vajzat e tjera. Unë mbeta e



fundit. Duke dalë, dëgjova frysëmarrje në krevaltin pranë derës. Luçi flinte akoma. Aman me këtë Luçin, ç'gjumë të rëndë që ka! Iu afrova krevatit të saj.

— Ngrehu Luçi, ngrehu moj motër! — i thirra ngadalë.

— Çfarë ke, moj mama? Lermë të fle... Një herë tjetër do t'ja kisha dhënë të qeshurit me të madhe, por s'ishte koha për të qeshur. Në kapannonin e djemve s'dëgjohej asnjë zë. Kishin dalë të gjithë në oborr. Luçi s'po ngrihej. E shkunda fort:

— Ngrehul... nuk jam mamaja. — Ajo u përmend.

— Ç'është, Vera?

— Ka rënë zgjarr, do shkojmë ta shuajmë.

— Ajo u ngrit. E lashë duke u veshur dhe dola jashtë.

Tri maqina ishin renditur njëra mbas tjetrës. Dritat e tyre llamburisnin. E para ishte «Zisi» i Markut. Në të kishin hypur vajzat (ne ishim shtatë). Lola më thirri nga maqina:

— Vera, eja këtu se e kemi marrë ne veglén tënde! — Duke u ngjitur në maqinë, u përplasa me një nga punëtorët e sharrës.

— Mbaju, he burrneshë! — më foli ai. Kalova përpëra dhe mbështeta duart në kabinë.

— Nisu Mark! — thirri komandanti. Errësira përpinte dritat e maqinës. Ato ndriçonin konturet e aheve. Pas nesh vinin maqinat e tjera. Djemtë këndonin një këngë partizane. Përpëra nesh qielli flakërinte. Kishte marrë zgjarr pylli. Punëtorët kishin shkuar përpëra.

Era që priste maqina në ecje, na thante së

ftohti. Ishte erë vjeshte. Kalova më mbrapa dhe lashë Luanin të rrinte para meje. Ai ishte trupmadh dhe era s'më zinte pas tij. I shtrëngojë fort supet, sidomos kur maqina merrte kthesat ose shukej në ndonjë gropë.

Ka çaste që nuk harrohen lehtë. Ndofta edhe ky çast ndonjë herë do të na kujtohet me mall, duke dëshëruar me gjithë zemër ta jetojmë përsëri. Unë isha në ankth. Diku pylli kishte marrë zjarr. Punëtori në maqinen tonë thoshte se zjarrri përparonte me shpejtësi. Pra, duhej ta shuanim. Edhe unë bashkë me shokët. Më dukej sikur dëgjoja zérin e motrës së madhe, që është mjeke, kur më tallte:

— Sa herë do të dalish sulmuese, moj Verë aksioniste?

— Sa herë të më shpallin! — ja prisja unë.

— Po sa, herë mund të të shpallin?

— Pse s'ke besim tek unë? — Ja ktheja me inat. Pastaj ajo heshtëte. Dukej që s'kishte besim tek unë. Më shikonte të dobët fizikisht e s'ja mbushja synë. Eh sikur ta kisha këtu pranë e të më shikonte se si po shkoja bashkë me shokët për të shuar zjarrin!

Zona e përflakur e qiellit nuk dukej më. Ishte mbuluar nga kreshtat e errëta të drurëve të lartë.

* * *

— Luçi!

— Ti thërrret, Vera?

— Mendova se s'kishe ardhur... — Ajo ishte nga fundi i karrocerisë. Unë shtrëngojë

fort supet e Luanit. Në qielj vetëtinin yjet. Hë-na ndriste si një helmetë e plumbtë.

Luani ja kishte marrë këngës me zërin e tij të ashpër e të çjerrë. Ai punon sa për katër. Apo s'e ka trupin si div. Lahet çdo mëngjes me ujët e akullt të kroit. Apo s'ka një oreks. Sapo hyn në mencë, i thërret guzhinierit:

— Prengë, dua të bluaj dhe barakën. — Luani e merr racionin dopio. E ka hak. Me atë punë që bën ai do një furre bukë. Ta shikosh kur punon! Thua se është ndonjë buldozer duke gërmuar dheun. Apo kur rrëmben gurët e mëdhenj dhe i flak në hon. Ditët e para habitesha. «Ç'e shtyn këtë njeri të punojë kaq shumë?» pyesja veten. Një herë e pyeta:

— S'e di — m'u përgjegj. — As vetë s'e di, por rrëmbehem i téri... Ndjem hem i lehtë dhe i fuqishëm. Ndofta është ndjenja e punës. Provo dhe ti të punosh si duhet — më tha. Dhe unë fillova të punoj me gjithë shpirt.

Një re e zezë kishte pushtuar gjysmën e hënës. Ajo dukej e alarmuar e nxítonte t'i largohej. Ndonjë insekt nate këndonte me zë të lehtë. Befas një flakë e madhe m'i verboi sytë. Mbylla qepallat. Kur i hapa, flakët ngriheshin të egra. Vendi shkëlqente, dëgjoheshin zëra njerëzish dhe zhurma e veglave. Ndaluam pas pak e zbritëm nga maqina.

* * *

Pylli flakérinte duke kërcitur egër. Po digjej një zonë e vogël, por ishte rrezik të përhapej më tutje. Një erë e ftohtë frynte me drejtim nga pe-

rëndimi dhe gjuhët e zjarrit drejtoheshin andej. Punëtorët po hapnin një shtek për të penguar zjarrin. Filluam dhe ne. Prisnim kaçubet, drurët e pyllit duke i hequr mënjanë. Punonim të gjithë pa fjalë. Herë pas here dëgjohej ndonjë urdhër i shkëputur. Unë isha djersitur ca nga puna dhe ca nga nxehtësia e zjarrit, që vraponte e dukej ashtu i frikshëm, me gjuhët e flakës që kërcënoin. Pranë nesh kaloi Gjini. Ai ishte një nga punëtorët e sharrës.

— Ju lumshin duart, mori varza — na përshtëndeti e u largua me grupin e punëtorëve. M'u kujtua dita e parë kur, sapo zbritëm nga maqina, të lodhur, me valixhet e drunjta në duar, hymë në mencë. Ne kishim veshur pantallona, punëtorët na shikonin me habi, veçanërisht mua që dukeshë më e vogla midis shoqeve. Atëherë Gjini më që drejtuar me këto fjalë:

— Prej kah keni ardhë?

— Nga Tirana. Kemi ardhë të punojmë.

— Të shkollës jeni ju a? — pyeti një punëtor tjetër, që rrinte prapa Gjinit.

— Po ne jemi studentë — iu përgjigja. — Kemi ardhë të punojmë.

— Paj, a ndjen, o Gjergj Marku? — iu kthyë Gjini, punëtorit tjetër. — Kanë ardhë varzat me punue, bre.

Këto kujtime më lëvrinin në kokë! Duke punuar, vetëm duart lëviznin veglën, mënjanonin kaçubet, kurse mendja bluante mendime, përshtypje e ku ta dish se ç'gjë tjetër?!

Bluza më ishte ngjitur pas kurrizit. Një tufë flokësh më binte fytyrës duke më penguar të punoj. Hera-herës ngrija kokën me rrëmbim, për

ta hedhur pas tufën e flokëve. U pendova që s'ki-sha marrë shaminë pér të lidhur kokën.

Nganjëherë ngrijë trupin, mbështetja duart në lopatë dhe hidhja vështrimin përreth. Luani kishte mbërthyer me krahë trungun e një peme të sapo rritur, të gërmuar nga rrënjet. Ajo i kishte rrënjet thellë në tokë dhe s'mund të shkulej lehtë. Zuri ta gërmojë akoma me kazëm pér t'i gjetur rrënjen. Pak më tutje një pemë u rrëzua me zhurmë. U dëgjua zëri i Rifatit që thërriste të ruheshim. Pastaj disa duar u mbërthyen mbi pemën pér ta zvarrisur. Zjarri po afrohej drejt nesh. E ndjenim gjithmonë e më tepër nxehësinë. Para meje kaloi Mëhilli. U ndal tek Luani, që po mundohej me rrënjen e pemës. Dicka i tha duke lëvizur duart. Buzëqesha dhe nisa prapë nga puna. Luçi më shikonte me habi. Unë gjithmonë bu-zëqeshja, kur shikoja Mëhillin. Ishte një mesoburrë, shpirt njeriu dhe gjithmonë gojëmjaltë. Një herë na zuri shiu duke punuar. Kapanonet i kishim një orë larg vendit të punës. S'kishim ku të mbroheshim. U shpërndamë nën kurorat e pemëve. Ne vajzat dhe një grup djemsh hymë nën një bredh. Aty shiu s'na zinte. Qielli i mvrejtur, buçiste nga bu-bullimat dhe derdhte shi pa pushuar. Ne rrinim nën bredh dhe bisedonim gjithë gaz. Këndonim. Shkrepima e një rrufeje na bëri të pushonim këngën. Mëhilli po vinte me vrap drejt nesh.

— Po ju, a jini të marrë që rrini nën bredh?! Dilni shpejt andej se bredhi e tërheq rrufenë!

Ne dualëm. Shiu s'kishte të pushuar dhe ashtu të lagur qull u kthyem në kapanon. Sepse më vjen të buzëqesh me Mëhillin kur kujtoj atë çast...

Kushedi sa kohë kishim që punonim, pa ndjerë si ecnin minutat, ndofta dhe orët, ku ta dish... Unë vetëm punoja dhe s'ndjeja asgjë. Nganjëherë shikoja zjarrin, dëgjoja kërcitjet e gjetheve të njoma dhe shikoja ndonjë dru, që rrëzohej me zhurmë i përpirë nga flakët. Kisha përpara një pemë të vogël. Doja ta shkulja. Lopatën e kisha ndrruar me një kazmë. Gërmaja në rrënjet. Toka ishte e fortë, e mpleksur nga rrënjet që më mbanin presën e kazmës të mbërthyer. Punoja pa ndjerë asgjë, as lodhje. Nervat i ndjeja të tendosura, ndërsa mendimet më vlonin.

Para dy ditësh kisha marrë letër nga babai. Sa i mirë është babai im! Në letër ai më tregon te se në këto pyje ku ne punojmë, ai kishte luftuar më shokët partizanë. Pastaj më këshillonte:

— Të jesh e guximshme, Vera!

— C'po bën, Vera? — Erdha në vete. Më pyeste Vjollca.

— Dua të shkul këtë pemë. Ndihmomë dhe ti!

— C'qenke e marrë! Lere ta shkulin djemtë. Unë e vështrova me inat Vjollcën, që iku në grupin e djemve pa më ndihmuar.

Më pushtoi përsëri dëshira për punë.

«Sa herë do të dalish sulmuese, moj Verë aksioniste?»

Një rrënje e trashë më lodhë. Ah sikur të kisha një sëpatë! Presa e kazmës ishte dhëmbëzuar. I bija me të rrënjes. Ndjeva që u pre, se kazma u ngul thellë në tokë.

«Paj a ndjen, o Gjergj Marku?... — kanë ardhë varzat me punue, bre!»

— Pema po lëkundej.

«Si do t'i dukem babait po t'i dërgoj një fotografi ku të kem dalë me pushkë, e shtritur si në pozicion luftimi?...»

Kështu mendoja gjatë këtyre përpjekjeve të mia pér të shkulur rrënjet.

E kapa trungun me duar e fillova ta tërhiqja. Befas ndjeva se e shkula lehtë. Ngrita kokën. Ish-te Luani. Atë çast më erdhi inat me të. Doja ta mbaroja punën vetë.

Zjarri po afrohej në zonën tonë. Kalova kurrizin e dorës në fytyrë pér të fshirë djersën. Vetullat i ndjeja të ashpra. Më ishin përcëlluar nga nxehësia e zjarrit.

* * *

A e dini si janë netët e korrikut në Krrabi, kur të duhet të mbulohesh me tri batanie brenda në kapanon?

Ne rrnim në një lirishtë e prej andej shihnim se si zjarri po shuhej krejt. Punëtorë e studentë bisedonin në të dy dialektet. Unë rrija e kërrusur duke pushtuar gjunjët me krahë. Më kallonin drithma në trup nga të ftohtit. Mendoja:

«Çfarë bën tani mamaja?... Patjetër fle... Edhe babai. Genci gérhet me atë zérin e tij të holli. Krevati im është bosh në dhomën e Gencit. Mamaja i hedh ndonjë vështrim, para se të shkojë të flejë në dhomën e saj. Nëna ime e dashur! Sikur ta dish tani se ne përgjojmë zjarrin, deri sa të shuhet duke u dridhur, nuk do të të zinte gjumi. Dëgjon, mama? S'dua të më thërresësh «Kanakarja e mamasë!»

— Ç'mendon, Vera?

— Mamanë... Po ti, Luan?

— Mendoj se sa mirë çfaqen karakteret e shokëve në punë, me vështirësitë... Ti po dridhesh... Ndjen të ftohtë?

Zjarri u shua. Pylli ushtonte nga brohoritjet e studentëve. Unë nuk thërrisja, por buzëqeshja e mallëngjyer dhe e kënaqur.

* * *

U drejtuam nga maqinat. Kur u ngjita lart, e ndjeva lodhjen. Por s'doja t'ja dija, isha e kënaqur. U ula e u mbështeta në spondin pas kabinës së shoferit. Të gjithë ishin ulur. U dëgjua zëri i Fuatit që ja mori një kënge labçë. Ja thyente Nasja. Të tjerët mbanin iso. Jonet e këngës vraponin bashkë me erën që linte mbrapa maqina. I këndonin trimërisë së një partizani. Kënga ishte e shtruar, e qetë, e përmallëshme dhe të fuste në mendime. Kënga të zgjonte qetësi në shpirt. Po dremisja nga lodhja.

Sytë po më kapiteshin për gjumë. Isoja e këngës dalngadalë po shuhej dhe unë s'dëgjoja më asgjë...

DITA E PAHARRUAR

Ish dita e dhjetë që ne, grupei vullnetarë i shkollës «Qemal Stafa» të Tiranës, shkollat e Lushnjës dhe të Krutjes, punonim në fushat e Myzeqesë. Gjatë atyre dhjetë ditëve e njohëm punën e krahut nga afër. Sa vështirësi hasëm ditët e para, ne të rinxjtë shkollarë që sapo lamë bantag! Duart tona të buta, që kishin mbajtur vetëm librin, u mbushën plot flluska që pastaj u kthyen në kallo. Sa shumë na digjnin krahët e djegura nga dielli! Por dhe me flluskat, kallot e me diellin përvëlonjës u mësuam. Ato u bënë shoqëruesit e pa-shmangshëm të punës sonë. Ndoshta kujtimi më i bukur, më i paharuari ndër ditët e aksionit që një mbasdite korriku. Ish koha e drekës. Vullnetarët mbas punës së lodhëshme, por aq të këndëshme, hëngrën me shijë drekën e gatuar nga gjyshe Dhoksia, nënë dëshmori, që erdhi vullnetare me ne, dhe u drejtuat në kapanonet e çlodhjes.

Për disa minuta në kampin e fjetjes ra hesh-tja. Vullnetarët pushonin.

Papritur në kaltërsinë e qiellit, tej nga lin-dja ku dukeshin ca kodra të vogla, filluan të vo-zisin re të bardha, që pastaj mbuluan gjithë qie-

lin. Qielli mori ngjyrën e plumbit. Një erë e ngrohtë shiu ngriti një re të madhe pluhuri. Drita zigzage e shndritshme që vetëtiu, u shoqërua pastaj me bubullima të largëta. Ish e qartë. Shiu po afronte me shtërngatë. Ndërkokë, nga kapanonet e djemve u dëgjua zëri i burisë. Të gjithë vullnetarët u ngriten nga ata tinguj kushtrimi. Duke vrapiuar, u grumbulluan në sheshin para flamurit.

— Shokë vullnetarë! — u dëgjua zëri i komandantit të aksionit në atë heshtje që pllakosi. Duhet shpejtar për të strehuar thasët me grurë, që ndodhen në lëmë. Ata s'duhet t'i lagë shiu që po afrohet.


Nuk pritëm asnjë sekondë. Të 600 vullnetarët u sulëm drejt lëmit. Po. Gruri duhej shpëtar. Dhe këtë duhet ta bënim ne, vullnetarët sepse të gjithë fshatarët ishin shpërndarë nëpër fusha. Filloi puna me një vrull të paparë. Vullnetarët shkonin e vinin duke mbajtur në krahë thasët. Dëgjoheshin vetëm fjalët:

— Shpejt, shokë, shpejt! Shiu po afron.

Kishin kaluar dhjetë ditë, por atë vrull dhe entuziazëm në punë s'e kisha vënë re. Bulza të mëdha djerse, që na mbulonin ballin, rrëshqisnin nëpër fytyrë dhe bashkoheshin me pikat e paratë shiut.

— Ja dhe pak mbetën, janë thasët e fundit. Një vrull dhe t'i shpëtojmë pa u lagur, — u shqua përsëri zëri i komandantit.

S'shkoi shumë, kur nisi shiu dhë nga fushat u derdhën duke vrapiuar fshatarët. Ata ishin me të vërtetë të alarmuar. Po ata shtangën që të gjithë kur panë që lëmi ish bosh. Kur na vunë re ne të la-



gur deri në palcë, që qëndronim nën një strehë, kuptuan gjithëshka. E kuptuan nga sytë tanë, ku shquhej ajo ndjenjë e bukur dhe krenare, gëzimi që jep puna. Dhe kishin të drejtë. Fituan mbi atë tekë të natyrës. Gruri nuk u lag. Vështrimet miqësore të fshatarëve u ngulën tek ne, vullnetarët.

Ndërkhë retë tekanjoze u shpërndanë rëndë-rëndë drejt perëndimit duke u përflakur nga rrezet e zjarra të diellit, që po perëndonte. Mbrëmja e asaj dite plot punë ishte shumë e bukur. Një fllad i ëmbël, që zuri të fryjë mbas atij rrebeshi i përkundëte lehtë gjethet. Në sheshin e flamurit, ku disa orë më parë në heshtje dëgjuam fjalën e komandanit, zjente kënga dhe vallja. Përsëri u dëgjua zëri i komandanit. Ai shpërndau në mes duartrokitjeve të zjarra shenjën sulmuese, dëshminë e djersës së derdhur për dhjetë ditë rrjesht. Përsëri buçiti kënga e kazmës dhe e pushkës. Këndova edhe unë me shenjën e sulmueses që më vezullonte si yll i zjarrtë në kraharor. Erdhi çasti i gjumit. Diçka kisha atë natë që s'më linte të flinja e qetë. Ndoshata ish gëzimi i vrullit të punës që më rrëmbeu atë ditë korriku.

XHA SULUA

(*Miku i kompanisë*)

Kur pylli akoma nuk kish lëshuar hijen gjigande mbi det, hapat e tij të ngadalta ngrinin fije të holla pluhuri në rrugën e ngushtë përmes arave. Fytyra e tij e errët plot rrudha, flokët gjysëm të thinjura, formonin një kontrast të papajtueshëm me verdhësinë e fushës së mbjellë dhe gjelbërimin e misrave.

Sytë, ngjyra e të cilëve nuk mund të dallohej nga rrudhat e shumta, lëvizin për disa çaste pastaj vështrojnë përséri rrugën e drejtë. Shati mbi supin e tij përkëdhel fletët e misrave dhe misrat kur shohin atë, zgjasin fletët për ta pushtuar, si zgjat foshnja duart drejt nënës.

— E, xha Sulo, paske dalë më heret se të tjerët, — i foli roja.

Buzët e tij të thata qeshën dhe treguan dhëmbët e krimbur e të zverdhur nga duhani. Uli përdhe shtamën dhe trastën me bukë, lëmoi me duart plot kallo shatin dhe filloi gjysëm i krrusur të prashitet. Dy këmbët dhe shati formonin një pri-zëm trekëndësh, një piramidë të gjallë mbi hapë-

sirën e gjelbër. Dalngadalë piramidat u shtuan, pushtuan tërë gjelbërimin. Misrat buzëqeshin...

Dielli si një copë e ngurtë lave, doli nga krameri mbas kodrës, hodhi rrezet e tija dhe elektrizoi vesën, bashkë me të dhe piramidat. Xha Sulua ngriti kokën. Në sytë e tij nderej një shkëlqim më i pastër dhe më i sinqertë se çdo pikë vese. Fshiu djersën, pastaj uli kokën dhe formoi përsëri pyramidën. Misrat buzëqeshin... Piramida ecën.

Ai po ha bukë. Pérreth i janë mbledhur të rinj. Ata e vështrojnë dhe ai flet. Tregon të njëjtën histori që ka treguar shumë herë, me të njëjtin ton, me të njëjtat fjalë, por ata e dëgjojnë, nuk ja presin fjalën. Ata gjejnë aty kurdoherë diçka të trishtuar që i trondit akoma më tepër dhe kjo tronditje i shtyn drejt punës më me vetmohim. «Eh djema, kështu i kishim punët ahore» — përfundon ai, lëshon një psherëtimë, ngrihet ngadalë, pastaj buzëqesh, thotë ndonjë shaka dhe përsëri lëmon shatin. Shikon lulet e diellit. Kokat e tyre kanë të tëra një drejtim. Sytë shëndrisin. Vesa tretet, ndërsa sytë mbeten të çiltër.

Dielli u fut në strofkën e tij në pyll, shati i dha përkëdheljet e fundit misrade, ndërsa koka e tij gjysëm e thinjur duket në mes të të rinjve. Ndoshëta tregon përsëri historinë e tij...

DITARI I NJË VULLNETAREJE

Në dorë më ra ditari i një vullnetareje. Po e
botoj ashtu siç është, duke i bërë tek tuk ndonjë
irregullim:

1 gusht 1966:

Sot u ngrita më herët se çdo ditë. Pothuajse s'fjeta fare. Gjithë natën mendova e mendova për aksionin. E, sa e lumtur jam! Qielli duket si një dekor madhështor. Lindja është mbytur në purpurin e zjarrtë. Disa re të lehta të bardha notojnë si mjeshtëria qellin e kaltërt. Kohë e bukur. Ujita lulet. Sa ua kam frikën atyre! Keti më premtoi se do të kujdesej për to. Porsa u zgjua, e mbulova me të puthura të zjarrta si e çmendur. Sa ngadalë ecin orët! Dje kishim mbrëmje vallzimi me rastin e nisjes. Kaluam bukur! Vetëm Zana qe e dëshpëruar. Përse?

Më në fund erdhi edhe çasti i nisjes. Gjithë rrugës u ngjirëm së kënduari e së brohorituri. E harruam veten në krahët e lehta të melodive gazmore. Po Zana më dukej si një problem i vështirë. Herë e rrëmbente ritmi i këngëve gazmore; herë

i mbérthente sytë diku larg e tretej në një mendim tē thellë që ja mbulonte ftyrën me një vello tri-shtimi.

— Zanë, q'ke kështu? — Ajo u drodh sikur po shkundej nga mendimi që e trishtonte.

— Asgjë s'kam!

— Jo, ti ke diçka. Zanë, mua ma fsheh? — M'i qepi për një kohë tē gjatë sytë e kaltër e pastaj tha me ndrojtje:

— Unë kam ikur pa lejën e babait.

— Vërtet??

— Iu kthye mëndja ditën e fundit. Unë s'mund tē qëndroja! Oh, s'do t'ja harroj kurrë mamasë! S'prisja tē ndodhët ashtu me babanë!

Buzët i dridheshin dhe sytë iu njomën nga lotët.

— Zanë, tē lutem hesht, — i thashë duke e përqafuar — ne do tē jemi gjithnjë bashkë.

Fshati ku arritëm ndodhet buzë Vjosës. Ka një pejsazh magjik e të egër si ata që pëershkuaran Bajroni. Rregulluam «krevatët». Bëmë me Zanën një dyshek kashte prej dy bataniesh, e ngritëm vëndin me gurë, shtruam shelgje e u bë një vend i re-hatshëm.

2 gusht.

«Çohu! Çohu!» Këto fjalë, që u shoqëruan me breshërimat e zërave tē tē gjithë aksionistëve, lajmëruan ditën e parë tē punës. Është herët dhe bën ftohtë. Lindja ka një ngjyrë tē verdhë portokalli. Ora tre. Kompania jonë do tē korri grurë...

Në fillim e pata vështirë. S'kam korrur kurrë. Na mësuan kooperativistët si tē përdorim drapërin.



Sa bukur dhe shpejt punojnë ata! Me shamitë e aksionit e bënëm arën të dukej si e mbushur me flutura. Mbas çdo minute që kalonte, linim prapa një masë të madhe are të korrur. Të bëhet zemra mal, kur sheh frutin e punës sate. Aty nga ora nëntë na doli një lepur. Të gjithë lanë punën e u sulën pas tij.

— Kapeni, kapeni shkelësin!
— Të hëngri, Landa!
— Ikë more, ti je më frikacak se lepuri, — i thosh Luani Fatmirit.

Kur u grumbulluam para mencës, mësuam se e kishim plotësuar normën. Ç'kënaqësi! Sa s'fluturonim nga gëzimi. Hëngrëm me uri. Sa shijshëm!

3 gusht.

Sot kompanisë sonë iu ngarkua një mision i vështirë. Duhej kaluar Vjosa më këmbë, herët, për të çkulur patatet e një parcele që ndodhej matanë. Sa e frikshme, aq edhe e bukur është, të kalosh në valët e tërbuara të Vjosës. Qemë mbërthyer fort njëri mbas tjetrit, si partizanët. Valët e furishme e të ftohta na përplaseshin në ftyrë. Si përgjigje, nga gjokset tanë shpërthenin meloditë e zjarrrta malore. Fshatarët na priten me një dashuri të vëçantë, kurse neve na guduliste gjoksin krenaria partizane.

— Tamam heronj!
— Jo, ne s'kemi bërë asgjë!

4 gusht.

S'kam qenë kurrë kaqë e mallëngjyer. Po prashitnim me Zanën, kur dëgjuam që dikush thirri: «Zanë!». Ktheva kokën dhe pashë babanë e saj. Po vraponte krahë-hapur drejt nesh.

— Zanë, bijë e babait! Ai i lëmonte flokët me duart e mëdha, kurse ajo dridhej si zog i trembur në gjoksin e tij leshtor. Tërë atë ditë ai qëndroi me ne. I ndihmonte herë Zanës, herë mua.

Vonë u mblodhëm për mbrëmje vallzimi me kooperativistët bashkë. Më mallëngjeu madhështia modeste e mbrëmjes fshatare. Salla s'qe gjë tjetër, veçse një shesh i rrethuar me ahe shekullorë, e ndriçuar nga fenerët e nga dritat e panumurta të yjeve. Kishin ardhur plot vajza fshatare. Sa bukur vallzonin! Ato kanë sy çuditërisht të thellë e të kaltërt. Na shikojnë me një vështrim admirronjës që të ngjall respekt e dashuri. Më kujtohet kujdesi i tyre në punë. Ato e ruajnë grurin si nëna fëmijën. S'dinë të ankohen kurrë.

5 gusht.

Korrëm. Në mbrëmje dhamë një çfaqje es-trade. Fshatarët qeshnin me lot. Secili prej nesh mundohej t'i kënaqte sa më shumë. Në fund ata erdhën e na përqafuan.

6 gusht.

Vajtëm dhamë numurin tonë dhe në një fshat aty afër. Rrugës takuam një bari me kopenë e vet. Ja kishte marrë ëmbël, ëmbël një kënge me

fyell. M'u duk, me atë trupin e tij kollos, si një kreshnik i dalë nga thellësitë epike të legjendave tona. Na tregoi një histori të lashtë barinjsh. Fshatarët miq na dolën përpara. Çfaqjen e dhamë në sheshin e fshatit. Hëna na qëndronte mbi kokë si një fener i madh. Fshatarët ishin ulur këmbë-kryq rrëth nesh. Në këngën. «Bashkohi, o shokë, me ne në çetë!» korit tonë iu shtuan dhe zërat e fshatarve. Buçima e tinguje të fuqishëm përplasej në shkrepat e egra të fshatit malor e rikthehej tek ne e transformuar në një jehonë të thellë si e dalë nga shpirti shekullor i shkëmbinjve të lartë. Kur jepnim skeçin fshatarët qeshnin me zë të lartë e aty për aty përsërisnin fjalët tona. Herë herë, të rrëmbyer nga kënaqësia, më pleqtë ngriheshin dhe na përqafonin në mes të skeçit. Një publik i tillë ta flladit shpirtin me bujarinë e zemrës së vet. Nënë, sa e lumtur jam!

7 gusht.

Sot qemë në një sektor të vështirë punë, në çkuljen e okrrës. Pranë nesh erdhën djemtë e kompanisë. Djemtë tanë janë më punëtorët e brigades. Punuam pa u çlodhur fare. Duart na u bënë plagë. Sanitarja s'ka patur, besoj, kurrë punë sa sot. Punova me Gencin. Çkulte sa për dy.

— U lodhe? — më pyeste shpesh.

— Jo!

— Mos ki turp nga unë! Çlodhu!

— Jo s'jam lodhur.

Sa bujar! Këtu po i njohim më mirë, më thellë shokët. Normën e plotësuam me vështirësi.

8 gusht.

U njoha me një shoqe fshatare. Më mori në shtëpi. Në mbrëmje shkuam në krua dhe mbushëm bucelat. Sikur ta kishin bërë me fjalë, po në atë orë erdhën gjithë vajzat e fshatit. Mësova prej tyre të tund qumiëشت. Kurse unë i mësova një vajze të bëjë dantelë dhe disa qëndizma të reja.

10 gusht e djelë.

U ngritëm më vonë se ditët e tjera. U lamë e u pastruam. Aty nga ora dhjetë u bë mbledhja e brigadës. U shpallën sulmuesit. Edhe unë është Zana morëm nga një «S». Si brigadë në dhjetëditëshin e parë dolëm 134 përqind. Në mbrëmje vallzuam.

11 gusht.

Sot ishim në prashitje misri. Një punë e loddhëshme dhe e vështirë. Toka qe e thatë dhe e mbushur me «shepla» balte. Na u bënë duart plagë. S'e bëmë dot normën. Kjo gjë sikur na e vodhi humorin krejt. Vajti ora 12. Askush s'pranoi të shkonte në kapanon. Erdhën shokët e kompanive të tjera.

— Ej, ju, vajti ora e drekës!

Ne heshtim si fajtorë.

Ata kuptuan gjithshka. Diç folën midis tyre, pastaj u derdhën tërë entuziazëm në arën tonë. «Përpara!». Ne sikur u përtërimë. Filloi kënga përsëri, shakatë.

— Nofulla të forta paska kjo arë, — tha njëri.

— Ne kemi zbérthyer katorin e binomit e
jo tē mos zbérthejmë nofullat e arës!

— Ore, po qënki dembela ju, o!

— Flasim ditë tjetër bashkë!

Mbas një ore pune u kthyem edhe, madje,
me një tejkalim modest.

12 gusht.

Sot qemë në korrje. E tejkaluam normën
158 përqind. Na quajtën kompania autokombajnë.

13 gusht.

Qielli është i vrejtur. Ka fryrë erë e fortë.
Retë na qëndronin si ombrella mbi kokë gjatë pu-
nës. S'ndjemë lodhje fare. Fshatarët mezi e presin
shiun. Edhe ne jetojmë me ankthin e tyre.

14 gusht.

Natën ra shi. Agimi i përlotur e i zjarrtë ka
derdhur në fushë mijra brilante vezullonjës. Sot do
shkojmë pak vonë në punë se toka është e lagët.
Dielli ra në fushën e njomur duke i dhënë dritë dhe
ngjyrë çdo këndi tē saj. Gjokset e maleve praro-
hen nga tili mjegullor. Bilbilat me zë magjepës
këndojnë madhështinë e këtij mëngjezi tē bukur...
Dita e punës qe e freskët, e gjithë brigada punoi
me një vrull tē papërmajtur, prandaj dita... u
sintetizua në shifrën rekord 183 përqind.

15 gusht.

Zana u sëmurë. S'mundi tē vinte në punë. Bë-
më dhe normën e saj. Kur i thashë në darkë se
edhe ajo e kish tejkaluar normën, qau.

- C'ke, Zanë?
- Më vjen inat, Mirë, ku e gjeta të sëmuresha këtu!
- Hesht budallaqe, sikur u sëmure vetë!
- Jo vetëm që lodheni edhe ju për mua, por ul edhe përqindjen. Më vjen plasje!

16 gusht.

Zana u ngrit të vinte në punë. Ishte përsëri sëmurë, por s'tregonte.

— Si je sot, Zanë — i tha Genci, komandanti i kompanisë, — mund të punosh?

— O, sot jam fare mirë, Genc!

Mua s'm'u durua.

— Je në vete, Zanë, ti je sëmurë. Ku do shkosh kështu?

Ajo u nxeh.

— Mira, leri shakatë, unë jam shumë mirë. Genci mori termometrin. 38 gradë!

— Ti s'do të vish në punë! — i tha.

— Genc, unë jam shumë mirë, s'dua të rri koton, pa punë, të lutem më lejo!

— Në asnjë mënyrë, Zanë, ti je sëmurë, shko shpejt në shtrat!

Iku pa më folur.

17 gusht, e djelë.

Shkuam me Zanën dhe me Dritën nga liqeni artificial. Ujrat e kaltërta fëshfërijnë si mëndafsh nga puhiza e lehtë e mbasditës. Liqeni është i thellë e tërë shelgje. Perëndimet e zjarcta e pra-

rojnë me një bukuritë të mahnitëshme. Shelgjet dridhen nën krelat eëmbla të luspave ujore e derdhen në imagjinatën e ndezur si flokët e shpupurisur të nimfave bukuroshe. Pyjet shekullorë shushurijnë në melodi të lehta, tëëmbla, që ta ledhatojnë e ta dehin kraharorin. Ç'mrekulli e bukur! Që të trija flisnim si të dehura, dhe mundoheshim t'i tregonim njëra tjetrës gjërat më të bukura!

18 gusht!

Çkulëm patate. Dhiqeli luante nga bishti e më mundoi më tepër. Duart tonë, duart «delikate» janë bërë të ashpra e të forta. Jemi nxirë së tepërmë. Djemtë punojnë pa kanatjerë e trupi u ka marrë një ngjyrë tëëmbël çokollate.

Aksioni është me të vërtetë një shkollë e madhe. Hej, të shikosh Lirikën, «bukuroshen delikate» si e quanin djemtë, Lirikën që fliste vetëm për moda dhe fustanë, Lirikën që të «mahniste» me përshkrimin e bukurisë së yjeve kinematografikë. Habitesh me të vërtetë. Sa vështirë e kerni pasur me të!

— Lirika, ti do vish në aksion me ne?

— Unë s'mund të punoj dot me kazëm, nuk mund ta duroj diellin, jam e dobët. Ju mendoni si të doni, por unë s'mund të vij!

Ja këto fjalë na tha në fillim kjo Lirikë që tani është skuqur e tëra prej diellit e i ka duart tërë kallo. Tani ajo është plotësisht e jona. Ç'forcë transformonjëse është një kolektiv i shëndoshë!

19 gusht.

Më dhimbte koka, megjithatë shkova në punë. Zana s'më linte të punoja fare. Ç'vajzë e mrekullueshme kjo Zana!

20 gusht.

Po shkruaj nën dritën e zbehtë të fenerit. Është ora një e natës. Porsa jemi kthyer nga çfaqja që dhamë në një fshat. Rrugës na zuri një shi i tmerrshëm, por më e egër u tregua natyra kur u kthyem. Vetëtima të njëpasnjëshme çanin qiellin e binin majë malesh si trëndafilë të zjarrtë. Shiu binte me rrebesch. Këmbët na futeshin deri në pul-pë thellë në tokën e qullur. Ne shkonim në njësh-kollonë e këndonim. Mbas pak shiu pushoi. Në malet e egër e të ashpër që na rrethonin u derdh me shkëlqimin e artë hëna. Kaluam edhe buzë një honi të tmerrshëm. S'di si t'i përshkruaj pam-jet e magjishme që derdhët atje vezullimi i artit Zana tha e prekur:

— Sa bukur! Forca bajroniane e së bukurës.

— Qëndruam të gjithë duke kënduar. Hodhëm në madhështinë e bukur zjarrin e këngës partizane. Shokët na dolën përrpara. Qenë çqetësuar. U përafuam sikur s'qemë parë prej kohësh.

21 gusht.

Kohë e freskët. S'e ndjemë fare lodhjen e punës. Po bisedonim me Gëzimin, shok klase, përnjë roman që kemi lexuar tanë kohët e fundit. Aty pranë kaloi Fatimeja, fshatarja që kam njo-

hur. Kur e takova, më bëri disa pyetje të çuditshme:

- Kushëri e kishe atë djalin?
- Jo, i thashë, shok klase! Përse pyet?
- Shok klase!? Po ti flisje me të... — u skuq.
- Si shok!
- Mira, po sikur të të shikonte babai, vëllai?!
- Asgjë, i thashë, pse ju s'flisni me djemtë?
- Flasim, por jo aq pranë.

Ndoshta ka të drejtë. Shpesh herë ne vajzat e shkollës nga njohja e tepërt e harrojmë atë distancën që egziston midis të afërmit dhe shokut.

22 gusht.

Asgjë pér t'u shënuar.

23 gusht.

Sot punuam në një front të largët e të vësh-tirë. Prashitëm lakra, punë kjo që kërkon mund e në mënyrë të veçantë kujdes. Disa herë me radhë brigadieri na ktheu mbrapsht. Dielli përvë-lonte si saç. Aty pranë s'kishim as ujë. Djaloshit, që sjell bucelat me ujë, s'i mjaftoi koha të vinte dy herë. Bredh gjithë fushën ai me atë kalë. Na është bërë i shtrenjtë ky kooperativist i ri. E presim si pret shiun toka e përvëluar.

Në orën nëntë e gjysëm s'kishim bërë as gjysëm norme. Një erë e thatë po e nxeh të na për-plasej në gjoks sa na merrte frymën. Ne punonim e punonim pa folur fare. Duart na u mbushën

tërë flluska mavi. Sumbullat e djersës ndiqnin njëra tjetrën. Askush s'kujohej të thoshte se orari i punës kish mbaruar.

— Hajt, çapajeva, mjaft punuat! — tha brigadieri. Të gjithë heshtëm sikur të mos kishim dëgjuar asgjë. Ai pastaj i vajti komandantit të kompanisë:

— Hë mo djalë, merri shokët dhe shko!

— Pa normën? Jo, s'mund të shkojmë!

— Sot e patët të vështirë punën — na tha ai, po ne s'pranonim të shkonim.

— Prashitja në vapë dëmton prodhimin! — na bindi më në fund brigadieri. Ikëm. Ndjenim një boshllëk.

24 gusht e djelë,

Brigadieri i kooperativës kishte dasmë sot. Ftoi edhe disa nga ne. Ç'dasma të bucura dhe mallengjenjëse që bëjnë! Ky fshat më duket i téri si një poezi tinguish e figurash. Nusja qante, kurse jashtë djemtë tanë këndonin:

... I ke naze gjith këto
Përse bën, moj sikur s'do
Gjeraqin' e bukur-o!...

S'kish parë fshati kurrë kaq shumë krushq sa sot. Gjithçka u mbulua nën këngët çapraxe të dasmës. Ne, të rinjve, po na u ndez shpirti, s'dimë të pushojmë këngët. Nuk do të përshkruaj dasmën, por vetëm them se më lanë mbresa të thella këto zakone të lashta që e ruajnë ende freskinë. Edhe ne i bëmë nuses një dhuratë të vogël.

25 gusht.

E bëmë dhe e tejkaluam normën pa vështirësi në çkuljen e patateve. Sot, pasdreke lexova disa tregime. Fituan për së dyti në volejboll kundër vajzave të kompanisë së parë.

26 gusht.

Sot jam mallëngjyer së tepërmë. Njoha me të vërtetë madhështinë e shpirtit luftarak të shokëve. Punoja në prashitje misri. Disa metra lart që kanali vaditës, ujët e të cilët vinte me motopompa nga Vjosa. Ujët kishte mbetur e s'ecte përpara. Shokët, një pjesë e tyre, ishin grumbulluar rrëth kanalit e punonin për hapjen e vendit përpara, kurse pjesa tjeter grumbullonte gurë e baltë për forcimin e murit. Të trembte kjo sasi e madhe uji që nga çasti në çast mund të çante murin e të derdhej në përrenjtë e thatë. Në fytyrat e djersitura të shokëve lexohej shqetësim e ankth. Dhe ja uji shëmbi murin dhe u derdh i papërmabjatur duke lëpirë me gjuhën e përbaltur "iithshka. Të gjithë u sulën atje. Djemtë u hodhën në pellg e mundoreshin ta zinin nga brenda. Të tjerët nga jashtë vunë gjokset tek e cara dhe mbareshin fort mbas njëri tjetrit. U formua një mur i dyfishtë gjoksesh. Ujët me gurë e baltë vërvshonte gjithnjë përpara, si përbindësh i zi. Brigada në alarm. Nga arat derdheshin të djersitur, e me vrap shokët. Ç'na e ngrohte zemrën kjo dashuri e tyre! Dëgjohej vetëm gurgullima e ujit dhe zhurma e mbytur e kazmave dhe e lopatave që përplaseshin me njëra tjetrën.

— Baltë! Shpejt, baltë!

— Kujdes mos vrisni shokët!

Erdhën fshatarët. U lajmërua shpejt tekniku të mbyllte motopompën, që villte me atë diametrin njëmetrosh ujë parreshtur. Puna ziente e vrullshme. Ishin këto me të vërtetë çaste të vësh-tira, emocionante, heroike. Të gjithë shpejtonin e mundoheshin të ndihmonin njëri tjetrin. Kjo betejë e ashpër mori fund vetëm mbas një ore. S'do ta harroj kurrë atë që ndodhi pastaj. Të gjithë u nisën për të ikur duke biseduar për ngjar-jen. Ligori, një djalë shtatlartë e téré muskuj po rrinte ende atje, tek muri i jashtëm i kanalit.

— Eja, Ligor!

Fytyra i qe zverdhur e tëra. Në buzë i kishte ngrirë buzëqeshja e ankthshme e fitores.

— Eja pra, ç'ke kështu?

— Asgjë, tha, kam vrarë pak këmbën.

Ne u sulëm drejt tij. Të gjithë u drodhëm, një plagë e thellë dhe e përbaltur. Gjithë këmba ishte mbuluar me gjak.

— Pak, pak! Buzëqeshja e ndrojtur iu mek në buzë dhe ra pa ndjenja në krahët e shokëve. Ishte vrarë që në fillim, po megjithatë harroi dhimbjen e vet e i vuri gjoksin vështirësisë. Në-në! Sa shumë kam për të të treguar!

27 gusht.

Në mëngjes mblohdhëm kallza gruri e afroam demetët e grurit pranë maqinës shirëse. Djemtë shinin. Mbasdreke shkuam me Zanën tek shtëpia e Fatimesë, asaj shoqes fshatare. Tundëm qumësht. Mbushëm bucelat me ujë. Nesër në mëngjes hërët do të mjelim dhitë.

28 gusht. Sot ne dhe fshatarët dhamë çfaqje për njëri tjetrin. Pastaj vallzuam. Ligori është më mirë. Orë e çast shkojmë të gjithë tek ajo infermieria e fshatit për ta parë. Gazeta «Zëri i Rinisë» kishte shkruar diçka për ne.

29 gusht.

Nesër shkojmë. Dola edhe një herë me Zanën larg fshatit. Perëndimi u përflak prapa malit dhe në fshat u derdh muzgu me fëshfërimën të aheve shekullorë dhe aromën dehëse të trëndelinës. Qëndronim pa folur duke përpirë me sy magjitet e mbrëmjes fshatare. U larguam vetëm atëhere, kur në ujët e mjelmët të liqenit artificial shkanë e ranë njëri pas tjetrit yjtë e zjarrtë.

30 gusht.

Dita e fundit. Mbrëmë deri vonë hëngrëm e vallzuam me fshatarët. Ata janë prekur për largimin tonë. U kemi lënë përshtypje të mira. Fatimeja s'u nda nga ne. Biseduam dhe i premtuam shoqja shoqes se s'do të harroheshim. Tani presim maqinat. Të gjithë janë të mallëngiyer. Fshatarët kanë dalë për të na përcjellë. Do të largohemi, por këtu lamë një pjesë të zemrës. Marrim me vete kujtime nga më të bukurat, më heroiket. Fatimja s'më ndahet...

Erdhën maqinat. Brohoritje! «Urra» të forta... Kur hipa në maqinë, më shkanë lotët. Po ashtu edhe Zanës e Fatimesë.

— Mirëupafshim, vëllezër fshatarë!
— Mirëupafshim!

MIRËMËNGJES, KATERINË!

Rrezja e diellit depértoi përmes perdes që lëkundej nga flladi mëngjesor e ra me drithërimë mbi jastëkun pranë flokëve ngjyrë ari. I ledhattoi një kaçurel, i fali ngjyrat më të ndritëshme e u ngjit me përtim mbi ballin e Katerinës që dremitë.

Mirëmëngjes, Katerinë!

Rrezja lozonjare goditi qepallat. Katerina fërkoi sytë. Buzëqeshi.

«C'ëndërr e bukur!... Sikur të vazhdonte! I mbylli sytë, por mrekullia s'po dukej më. Ajo s'i arrinte dot shoqet, as shkëmbi nuk çfaqeji. U kthye nga ana tjetër, por ëndrra kish fluturuar.

Katerina s'u mërzit. E pse të shqetësohej? Ëndrra ëndërr do të mbetej, kurse e vërteta ishte e bukur. Këtë të vërtetë ajo e mësoi mbrëmë nga mjeku.

— Tashti je shumë mirë, Katerinë! S'ke asnje rrezik. Për dy tri ditë mund të shkosh në aksion.

Ajo kish hapur sytë e s'kish folur. Pati frikë se mos dhe një fjalë e vetme e saj do të zkonte lajmin e gjuar. E pa mjekun e buzëqeshi. Dhjetë ditë më parë po ky mjek i kish thënë: «Në

asnjë mënyrë s'do të shkosh në aksion». Ajo kish qarë. Mjeku përsëri kish folur: «Janë kriza të rënda» dhe e kish pyetur se sa herë kish vjellë. Katerina kish ulur qepallat e s'kish nxjerrë zë. Kriza e stomakut i vazhdoi dhe tri ditë të tjera. Një natë më parë se të niseshin shoqet e shokët e saj për në Jonufër, ajo mezi i duronte dhëmbjet. Kafshonte buzët, mundohej të buzëqeshte, por djersët që i delnin palë-palë e tradhëtonin. Shoqet u zbehën më tepër se ajo.

— Ne do të presim, — i tha Natasha kur i dha dorën, — sa të shërohesh eja.

— Të tjerat buzëqeshën e Katerinës iu duk se i thanë: «Hajde Rinka, hajde!» Ajo puliti qepallat për të fshehur lotët dhe u shtrëngoi dorën shokëve. Të nesërmen, i dalloj ata në vargun e gjatë që gjarpëronte bulévardit. Kur iu afruan godinës ku banonte ajo, ata qëndruan, hodhën vështrimet sa nga një dritare në tjetrën, kërkoinin atë, Katerinën.

— Do ta hapësh dritaren? — pyesnin vështrimet e tyre.

— Jo, — thoshin sytë e mjergulluar, që pas perdes prej tantelle.

— Vërtet s'do vish, Rinka? — thoshte grupi që s'lëvizte.

— Ja, prisni prisni, shoqe. Unë sot jam më mirë, nuk ndjej asnjë dhëmbje, — thoshte Katerina, megjithëse buzët heshtnin, ato mbanin myllur aty në grykë dhimbjen!

— Katerinë! — thirri Natasha.

— Katerinë! — thirrën shokët dhe vargu lëvizi. Katerina u ul në minder dhe ndjeu lotët në faqe. Brohoritjet që vinin nga jashtë, s'donin të

dinin pér asgjë, ato pérplaseshin mbi xame, shëtisnin sa nga një mur në tjetrin, ato ishin zot të asaj dhome. Vargu i aksionistëve akoma vazhdonte. Fundi kushedi se ku ishte, kurse ata, shokët e Katerinës, lëviznin pérpara. Dhe Katerina, me sy të mbyllur, me lot të tharë, lëvizte bashkë me ta, lëkundte shaminë, këndonte.

E tillë ishte dita e parë. Pastaj kish ardhur një letër. Katerina me motrën e saj të vogël, sapo ish kthyer nga poliambulanca, ku kish bërë analizat e një radiografie. Letra ish shkruar me laps. E kish shkruar Tasha, po e kishin firmuar dhjetë veta. Në fillim e pyesnin pér shëndetin e saj, në një rrjesht e thërrisin, në faqen e dytë shkruanin pér bregun e Radhimës, pér diellin, pér vapën, pér çfarë nuk shkruanin! Faqen e katërt Katerina akoma s'e kish lexuar. Ajo kaloi sytë përsëri në faqen e parë, u ndal pér të parën, të dytën, apo të tretën herë në ndonjë radhë që i pëltente e kur afronte pranë së katrës, ngadalëson te leximin. Donte që letra të ish pafund, donte ta zgjaste kënaqësinë që ndjente duke e lexuar.

— Ç'të shkruajnë, Rinkë?

Ajo e kish puthur në ballë motrën e vogël.

— Shumë mirë shkruajnë, Lola. E di si?» Ne jemi skuadra e parë, efektivi 11, prezent 11. E kupton, Lola?

Po Lola tetëvjeçare s'kuptonte gjë.

— E ku di ti, moj Lola, 11, moj, dëgjon? Dhe e njëmbëdhjeta jam unë, unë Rinka.

— Ohu, — ja kish kthyer Lola e kish dalë nga dhoma. Kurse Katerina ish gajasur. E njëmbëdhjeta ish ajo. Kështu e paraqesin forcën shokët e saj. Punonin dhe pér të dhe e tejkalonin nor-

mën. Ata e thërrisin të shkonte pranë tyre. Le të punonte sa të kish fuqi, veç të ish aty me ta.

Katerina sa s'fluturonte atë ditë, aq më tepër që mjeku i kish thënë: «Me që s'ke dhimbje, po të të dalin analizat mirë, mund të shkosh në aksion». Dhe ja mbrëmë, duke i kontrolluar ato letra që flisnin mbi gjendjen e Katerinës, ai i tha: «Nisu, Katerinë!»

* * *

Ajo ish ulur përpara në kamion dhe kish shpërndarë mendimet në rrugën që dredhonte, në djeillin që herë i delte majtas, herë para. Mendimet fluturonin dhe në taracat që akoma s'i shihte. Sikur këto taraca të ishin buzë rrugës ku do të qëndronte maqina, shokët e saj do fluturonin drejt saj, do ta rrethonin, do t'ja prishnin fare mendjen. Ndoshta ata do të ishin kthyer nga puna. Nga larg do ta dallonte ndonjë i grupit të saj. Dhe pastaj... Katerina buzëqeshi.

— Kjo është Lushnja, — i tha shoferi.

Dhe mendimet e çakarritura erdhën e u mblo-dhën në një të vetëm.

«Ja si qënka Lushnja, me pallate të mëdha, me lule nëpër ballkone, kish dhe vajza me syza, kurse fëmijët vraponin buzë kanalit vaditës. Ma-qina fluturon e bashkë me të dhe Katerina. Ajo dremit me sytë e hapur, kokën mbështetur te dritarja. Dhe e pa Fierin si nëpër èndërr.

— Mos e kaluam uzinën?! — pyeti ajo e shqetësuar.

— Jo, jo! Mos ki merak, të thashë që do të ta tregoj. Katerina buzëqeshi.

— Ja po afrojmë, këtej, këtej nga e majta. I shikon kullat?

Shoferi ngadalësoi marshin, e megjithatë Katerina s'arriti të shohë gjithçka. Por kullat e larta që shkëlqenin sikur të ishin veshur më ar, dhe oxhaku që naltohej një me retë, i bënë përshtypje të madhe. Ndërsa maqina shtonte marshin e u ngjitej të përpjetave, Katerina shihte gjethet që lëkundeshin njëra më shumë se tjetra e kjo i dukej si një valvitje flamujsh, shamijash, lulesh, një valvitje e papërmabjatur entuziaste. Në sfond të kësaj valvitjeje llamburisnin, vetëtinin kullat e larta, që s'mund t'i hiqeshin nga sytë.

— Këtej fryka erë! — tha ajo e gjallëruar.

— Është era e detit!

Katerina puliti sytë.

«Është era e detit» — kjo do të thoshte se së shpejti do të ndodhej atje, midis shoqesh, kjo do të thoshte se aksioni ishte shumë afër. Aksioni, kazma, lopata, ajo me pantallona dhe shoqet...

Kamioni ndali te ura rrëzë kodrës. Katerina me një valixhe të vogël mori rrugicën në të djathë e zbriti poshtë. Përpara saj ecnin ngadalë-fare ngadalë 4-5 aksionistë, kurse aty në qendër, mës tendave të rrethuara me mare e fiera, pranë një autoboti, ishte mbledhur një turmë e madhe vajzash e djemsh që mbanin gavetat në duar. Katerina u hutua. S'dinte kujt t'i përgjigjej më parë. E kishin rrethuar një grup vajzash. Njëra e pyeste nga kish ardhur, tjetra i thosh kë kërkonte, dikush kërkonte të dinte për Tiranën. Katerina i shihte ato fytyra të panjohura e mundohej t'u përgjigjej.

— Hajt shkojmë në qendrën e zërit, aty do t'i thërrasim shokët e tu, — i tha një vajzë buku-roshe dhe i mori valixhen nga duart.

«Ja si qënka këtu» — mendonte ajo ndërsa ecte pas vajzës me bishtaleca. «Një mizëri e të-rë...»

Në qendrën e zërit ajo pa një djalosh që fliste pranë një mikrofoni. Vajza me bishtaleca bu-zëqeshi.

— Dëgjoje, i tha Katerinës, — kur është në qejf ky, ne gajasemi fare. Është një numër më vete i aksionit.

— Po ju? — u drejtua ai tërë gaz nga dy vajzat.


Katerina i tregoi se kishte shoqet këtu, se kish ardhur të punonte me to.

Ai e pyeti për emrat e tyre, i shënoi në një letër dhe afroi mikrofonin.

— Vini re! Vini re! Natasha, Drita, Lekua... gjithë skuadra e I-rë e kompanisë së III-të, brigada e V-të të paraqitet në qendrën e zërit.

Zemra e saj rrahu fort, faqet iu dogjën, ankthi desh i zuri frymën. Ku të rrinte? Midis derës, jashtë, apo... Po të mos ishte ai djaloshi aty pranë tavolinës, ajo do të fshihej e do t'i kish trembur shoqet, kurse tashti as ajo s'dinte si të bënte. Ja Tasha qëndron te dera dhe s'e dallon fare. «Më kërkuat»? — pyet dezhurnin dhe s'vështron nga ana tjetër.

— Uh Rinka, Rinka moj, — thirri Drita që pas Tashës e u hodh në krahët e shoqes. Më vonë, kur Katerina donte të sillte ndërmend këtë çast, i dukej se kishte parë një ëndërr. Mezi kujtohej, si doli nga qendra e zërit, si i takoi të tërë



ata, të 10 shokët e skuadrës së saj, si mbrriti te kapanonët, fjalët që tha e dëgjoi. Të gjitha këto sikur filluan e mbaruan në çast, sikur fluturuan me flëadin e lehtë që vinte nga deti.

— Tashti rri këtu me mua, — i tha Tasha. — Pastaj i rregullojmë vëndet. Dale të hamë një herë bukë.

— Kjo është gaveta jote, këto bataniet. Deri tashti përgjigjeshim ne. Merri nën përgjegjësinë personale. — Drita fliste me seriozitet të madh.

— Ka dalë e dalluar sot, — tha dikush aty pranë.

Katerina vetëm queshte. Qeshte e dëgjonte. E çfarë të thoshte ajo?

Drita e diellit depërtonte përmes tendës e i kish mbushur me shkëlqim e bardhësi kapanonet, ku flinin vajzat. S'kuptohej ku fillonte e ku mbaronte një shtrat.

— Flemë të gjitha së bashku, njëra pas tjetrës, — i thanë Katerinës. — Dhe ty do të të fusim në mes.

— Zgjerohuni pak! — thirri një vajzë nga fundi i tendës. — Të heqim këto valixhe që të hapim një vënd. Rregullojeni shoqen!

Katerina u hutua. S'dinte ç'të bënte, kë të shikonte.

— Me këtë rast rregullojmë dhe shtretërit tanë, — tha një vajzë e bashkë me dy shoqe shkoi të mblidhët kashtë.

Tasha tha, se Katerina do flinte pranë saj. Ato do të shtronin dy batanie, dy do t'i bënин jastëk e me dy të tjera do mbuloheshin. Deti natën bëhej ziliqar. Kur e zgjonin dallgët, shfrynte i ina-

tosur dhe lëshonte freskinë mbi gardhet e tëndave.
Dy batanie duheshin medoemos.

Rinka u shtri mbi batanien që e shponte. Shih-te tendën vija-vija që ish tendosur mbi kokë të saj, atë copë basëm, që kish shpërndarë rrezet e die-llit, që i kish zënë gjithë atë qiell...

Lëvizi e u kthye nga Tasha. Kjo i buzëqeshi e i tha ngadalë, fare ngadalë:

— Do të mësoshesh, Rinka... E di e di... mos thuaj kot se je shumë mirë. Ditën e parë aq më shponte batania, m'u dërmuan kockat. Po vetëm ditën e parë. Tashti as që pyes për gjë. Pa le Drita... Të të thotë vetë ajo. Dy ditë mezi e kafshonte bukën. Tashti na thotë: Shiko, dua të ha dhe në orën 10. Kështu është këtu, Rinkë, do ta shikosh.

* * *

Të nesërmen, me dy gjyma ajo ngjiti kodrën. E kishin caktuar të mbushte ujë. Kapela me strehë ja mbulonte krejt ballin, nën të shkëlqenin e qeshnin dy sy gështenjë.

— U lodhe, Katerinë?

Një shok zbriti që ta ndihmonte.

— Unë?... — Ajo buzëqeshi. — E ç'bëj unë?

— Tashti çlodhu. Ne pimë vetë. Kur të mbarohet, do shkosh prapë.

Këtë punë filloi të bëjë Katerina. Kur ngjitej kodrës me gjymat e rëndë e vënde vënde ndalej për të pushuar, ishte e bindur se po punonte si gjithë të tjerët se s'qëndronte kot aty në aksion, por kur priste aty në taracë sa të mbarohej uji dhe shokët s'e lejonin të kapte lopatën, ajo ankohej,

mërzitej që s'kish punë si të gjithë. «Pse për të ndenjur kam ardhur?» thoshte me vete.

Dhe Lamja, bufi i kursit si e quanin ato, ai që i kish shkruar në fund të letrës: «Hajde, Rinkë, se gjysmën e normës do ta bëj unë», pikërisht ky Lame i thosh: — pse bëhe sikur s'kupton moj Rinkë. Demek të kemi dhe të shkëlqyer. Atëhere pse s'i lidh fenomenet? Si thonë për ne aksionistët? Do derdhim djersën. Thonë kështu apo jo? Po djersën kush na e formon? Hë, moj Rinkë, mos u hiq sikur s'kupton dhe mos u anko sikur s'punon».

Qeshte dhe Rinka bashkë me të tjerët dhe për të mos mbetur pas tyre, ajo e zbriste kodrën rrëmbimthi për ta prurë sa më shpejt djersën e saj në taracë. Një herë ndërsa ngjiste rrëpirën, Katerina dëgjoi shokët që flisnin me zë të lartë:

— Të na kiske thënë që dje — ky ishte zëri i Lames.

— Po, po — gumëzhinin të tjerët. — S'është e drejtë.

Katerina e shqetësuar vrapoi te shokët që kishin rrethuar teknikun e s'donin të bindeshin.

— Çfarë ka ndodhur? — pyeti ajo.

— Thotë se do të na e zgresë normën. Dje nuk e kemi sheshuar si duhet taracën; jo vetëm ne, gjithë brigada jonë. E humbëm flamurin.

— Punoni tashti, mjaft bëtë fjalë! — thirri Tasha. Vajzat të shkojnë të sheshojnë taracën.

— E pse të bëjmë punë të dytë? — u hodh njëra. — Të na udhëzonte drejt qysh dje.

— Lerini fjalët... Ç'faj ka tekniku. Dhe ne e dimë që dheu s'duhet të qëndrojë kapicë. Një shi të bjerë dhe ai prapë kthehet në vend të vet. Thuaj na erdhi për mbarë...

Dhe Tasha rrëmbeu kazmën.

Katerina shkoi pas vajzave që po drejtoheshin për në taracë. Mori dhe ajo një lopatë.

— E pse të na ikë flamuri? Të vimë pasdite tē punojmë. Pse ta lemë flamurin?

— Brigada VIII është shumë përpara sot, si duket u dehëm nga sukseset ne. Katerina mbushte lopatën dhe flakte dheun në prroin e thatë.

— Mëngadale ti, mos na u mbur, — i tha Drita.

Katerina buzëqeshi.

— Më keni dhënë lejë tē punoj aq sa kam fuqi? Më keni dhënë. Atëhere?

— A keni ujë, ju andej? — thirrën nga taraca.

Katerina rrëmbeu gjymin dhe në çast u ndodh atje.

— Sot do tē tē lodhim, Katerinë, — tha Lamja. — Do pimë shumë ujë sot.

Ajo ua mbushi shokëve gavetat e zbriti kodrën. Dikush e thirri te autoboti.

— E, Katerinë!

Ajo e vështroi vëngër shokun pranë.

— S'qënke në qejf sot, e po flamuri s'është vetëm juaji, do ta provojmë dhe ne.

— S'dihet, ja ktheu ajo, — pse mburreresh kaq shpejt?

Kur u ngjit në taracë, nuk ua tregoi shokëve bisedën e zhvilluar, kapte plisa, barishte dhe i rrokulliste kodrës.

Atë drekë askush nuk pyeti fare se çfarë do tē hanin, askush nuk e lavdëroi turlinë që ish bërë aq e shijshme, asnjëri s'e zgjati gavetën përtë marrë përtë dytën herë. Dhe vajzat s'ua mu-

arën enët djemve pér t'ua larë. Çdo gjë u krye në heshtje.

Në kapanone bënte vapë e madhe. S'frynte asnjë grimë ere. Vajzat ktheheshin sa në një krah në tjetrin, por gjumi s'i zinte.

Katerina rrinte symbyllur. Sa të gëzuara ishin katër ditët e fundit! Skuadra e tyre mbante flamurin e zbriste kodrës duke kënduar.

— Hajt, Katerinë, një këngë tjeter, — i thonin shokët. Dhe ajo ja niste. Pastaj aty pranë kapanonit dikush do t'i thosh: «Një gllënkë ujë nga gjymi yt, është baraz me 20 lopata», një tjeter i jepte kumbullën apo dardhën e ruajtur pér të e ajo kthehej në kapanon e qeshur, e gëzuar. Kurse sot? Sot të gjithë kishin heshtur, sikur të kishin humbur fjalët. Dhe Katerinës as i flihej, as i rrihej.

* * *

— Në një? — e pyeti dikush Tashën.

Ajo bëri sikur s'dëgjoi. Dhe shoqja heshti.

— Çfarë keni kështu? — tha Katerina, por s'mori përgjigje.

Vetëm në mbrëmje, kur ora kaloi tetën dhe shoqet e saj shpejtonin si asnjëherë pér të fjetur, ajo e kuptoi se do të ngriheshin natën pér të punuar. Vendosi t'i bëjë veshët katër, pér të mos i shpëtuar asgjë. Por deri në orën një ishte larg. Dhe Katerina s'e mori vesh kur shoqet u ngritet. Hapi sytë dhe u mërzit kur s'i pa pranë. Si kishin ikur aq pa u ndjerë?! Dhe mos t'i thoshin një fjalë?! Kontrolloi te vendi i veglave.

Kontrolloi kot, se s'kish më dyshim, shoqet ishin
nisur pér në punë.

Ajo u vesh shpejt e shpejt, as sytë s'i lau, as
flokët s'i krehu, i lidhi me shallin e mori gjymat.
Autoboti ish në mes të sheshit. «Po a do të ketë
ujë?» u tremb Katerina. Ish një frikë e kotë. Gjy-
mat u mbushën dhe këmbët e Katerinës morën të
përpjetën. Harku i hënës nxori kryet nga të çar-
rat e resë dhe zboi errësirën. Katerina ecte mes
kashtës së prerë të grurit, dhe ndjente ankimin
e ujtit që nga gjymat: glluq, glluq...

Aty pranë kanalit, buzë rrugës, desh i rrësh-
qiti këmba. Një pjesë e gjymit iu derdh, iu njo-
mën pantallonat, por Katerina nuk e qortoi na-
tën me yjet që dridheshin e s'shuheshin dot. Ta-
racat po afronin, por shokët e saj s'dalloheshin
fare, megjithëse zërat e tyre vinin që afër. As ata
s'e dalluan Katerinë, ndaj ngrinë në vend, kur
ajo u çfaq para tyre si fantazëm e thirri:


— Ujë, kush do ujë, shokë?!

— Katerina?!... Mirëmëngjes, Katerinë!

Shokët lëshuan veglat dhe i vajtën pranë.
Ecën ngadalë, pa bujë dhe e rrethuan. Ata nuk
folën, s'thanë asnjë fjalë, shikonin si të habitur
e qeshnin, kurse Katerina belbëzonte:

— Sa të këqinj që jeni!... E pse më ndatë?
Gjithmonë të sëmurë do të më quani ju?!

— Hajdeni, urra, — thirri Lamja dhe e go-
diti shkëmbin. Hëna që pas resë përgjonte, ndër-
sa yjet dridheshin e dridheshin me një dritë të
largët dhe të pashuar atje lart në kubenë madhë-
shtore të qiellit.



NJË NATE VERE

— Tregim —

Pylli me dushq të rinj mbaroi dhe lopët tonë dualën në ca livadhe që i lagte vesa. Tashmë ne s'e kishim atë ndjenjë frike që na kishte push-tuar atje mes drurëve të errët, bile as atë ankth të çuditshëm që na kapte kur mendonim se lopët do të trembeshin e do të merrnin arratinë. Jo, jo! Këtu në livadh ishte aq bukur, në brigjet e lumit shushurinin shelgjet nga frysma e natës dhe diku cicérinin mbetur bilbilat e përgjumur, që era ua çonte zërat larg.

— Ai — ai! Aji — aja! — u bërtiti lopëve Myska dhe unë ndjeva një gaz të madh në zemër, kur dëgjova zërin e tij të gëzuar. Këmbët, llërët dhe fytyra na digjnin nga gërvishtjet, ne kishim rendur mbas lopëve orë të tëra nëpër pyje, shkurre e skuta, herë-herë zëri na dridhej gadi më të qarë kur ndonjë dem kryeneç bënte «myyy» e na ndahej nga tufa. Po tashti kishim dalë në këto lëndinëza të bukura; ato ngjanin sikur qeshnin nën dritën e kaltëreme të hënës dhe, ndërsa ec-

nim mbas hijes së lopëve, e ndjenim veten të leh-të e të gëzuar si ajo erëza e luleve të blirit që vinte nga pyjet. Bëra dhe unë nga gëzimi:

— Ai-ai! Aji-aja!

Zëri jehoi diku larg nëpër shkëmbinjtë e luginës së Matit, përshkoi gryka e hone si një tinguill i mprehtë e i dridhshëm dhe pastaj u tret dalngadalë nëpër natë. Kopeja shkelte varg e varg në një udhëz me gëmusha bushash për ane, këpucët i kishim hequr me kohë dhe tanë ndjenim pluhurin e butë të rrugës tek na guduliste putrat e këmbëve.

Unë dhe Myska ishim vullnetarë të «Rrugës së Dritës» në sektorin e Shkopetit. Unë me të u bëra shok i ngushtë qysh në ditët e para të aksionit, sepse punonim në një skuadër dhe flinim pranë njëri tjetrit. Atë mëngjes ne na thirri komandanti i brigadës dhe na tha se duhej të shkonim për të marrë nga tridhjetë lopë në Skurajt të Millotit. Këto lopë për mish duhej t'i sillnim në sektor e komandanti tha se këtë punë ne mund ta bënim, sepse ishim djem të shkathët dhe se nuk do t'i linim lopët rrugës. «Hapni sytë — na tha ai, — s'është kollaj të biesh tridhjetë lopë nga Skurajt këtu. Rru-ga shkon në shumë vënde nëpër pyll dhe shikoni mos u mbetet ndonjëra prapa».

Po ku pyesnim ne se nga shkonte rruga e sa lopë ishin? Ishim të dy 16 vjeçarë: si unë, si Myska, shoku im. Komandanti kishte besim se këtë punë ne do ta bënim dhe kjo na i pat mbushur zemrat plot. Pastaj, përpara kishim luginën e Matit, ujrat e lumit vënde-vënde të rrëmbyeshëm e vënde-vënde të qeta nëpër pellgjet e mëdhenj nën hijen e drurëve, pyje, vënde të bukura e të panjohura; prandaj shkonim drejt Skurajt, shko-

nim tē lehtë e tē gëzuar përmes piskut tē vapës dhe këngës së pasosur tē gjinkallave. Na dukej gjë e bukur tē bënim tri-katër orë rrugë vajtje dhe 3-4 orë ardhje me tridhjetë lopë përpara e rendnim gjithë gëzim nëpër udhëza e monopate. Djer-
sa na mbyti fytyrë e trup, pluhuri na pudrosi, po ne s'ndalnim së ecuri anës bregut tē lumit.

Në Skurajt na i dhanë lopët dhe ne u nisëm përsëri për në Shkopet, aty nga ora tre e mbas-
dites.

Vumë kopenë përpara dhe Myska, duke kthyer kokën nga dielli, tha:

— Më tē perënduar jemi atje.

— Në mos më parë — i them unë. — Vec duhet t'i nxitojmë e t'i ngasim shpejt, se ndryshe na zë nata.

— Ashtu, ashtu! — pranoi Myska dhe, si ngriti stabin në ajër, u bërtiti lopëve:

— Yy, ajs, ajs, ajs...

Ato nisën t'i hedhin çapet më me nxitim në pluhurin e rrugës, kurse unë, i gëzuar për Mys-
kën që dinte ta ngiste kopenë, i them:

— E nga i di tërë këto, o Myskë?

— E si ore s'i di, — ma preu ai — bile dhe vrri, vrri-vrri t'ja bësh lopës, ajo do tē rendë kur tē sheh në dorë kopaçen.

Por s'paskej qenë aq lehtë. — Sapo dualëm nga Skurajt, nisën avazet. Një lopë nisi ta shtrën-
gojë zekthi. Ajo ngriti bishtin, filloj ta dredhë në erë duke i rënë me nervozizëm kurrizit dhe pastaj u lëshua drejt lumit me tē katra.

Ne na u shua gazi nga fytyra. Kujtuam se lopa do tē ndalej diku aty afër, po ajo rendëte e rën-
dëte, u binte me brirë gëmushave, mualliste dhe

hidhte vickla. Atëhere Myska ngriti stapin në ajër, u lëshua me rrëmbim duke vrapuar gjatë një gardhi me ferra dhe nisi të bërtasë me një zë që i dridhej e gadi më të qarë:

— Dale, dale, dale...

Mua desh m'u qesh, po si mund të qeshje? «E ku di lopa dale-dale, mor Myskë» — thashë me vete dhe mezi kapërdija një gjyç që më qe mbledhur në grykë. Më ngjante sikur të gjitha lopët tani do të nisnin atë vrap të çmëndur, prandaj nxitova, dola në krye dhe e ndala karvanin midis dy gjerdheve, në një vend të ngushtë. Që këtu shihja këmishën e bardhë të Myskës, që kish dalë atje në brigjet plot zall të lumit dhe më tej akoma, në ca hamullore që përzhiteshin në diell, shihja lopën e murrme. Ajo më në fund ndali dhe Myska, duke ecur herë nëpër kanale e herë nëpër mezhda si ai gjahtari që i afrohet gjaht, arriti pranë saj. Shkopin e mbante të fshehur prapa kurrizit, i afrohej Murrës me çap të pasigurtë dhe së fundi arriti ta kthejë drejt kopësë. U kthyte i skuqur e i djersitur i téri, fryma i merrej dhe në faqe i dukej një e gërvishtur e kuqe.

— T'u rrimë afër, — më tha. — Mos t'i lëmë të hapen shumë.

Po ne nuk patëm shtektaur kurrë lopë. A mund të ishte kaq e thjeshtë? A dinim ne ç'të bënim kur lopët merrnin tri drejtime, kurse ne ishim vetëm dy? A dinim ta bënim zap një muzat që i tekej të hidhte shkelma, t'u binte me bri-rë shkurreve e të mirrte nëpër pyll me sy të zgurdulluar? Ne bile i trembeshim këtij muzati, në sytë na mblidheshin lotë dhe prisnim gjersa atij t'i

binin xhindët. Pastaj i aviteshim dalngadalë, i luteshim me plot fjalë të ëmbla që ai të kthehej në kope dhe muzati, siç shihej, s'ish aq i keq sa dukej, sepse këpuste dy-tri fije bar me majën e buzëve, tundëte kokën duke çfryrë dhe i mbushej mendja të vinte me ne. Atëhere zemrën tonë e pushtonte një gëzim i çuditshëm, u binim lehtë vitheve lopëve të urta e u thoshim: haj Murgjini, haj Baliskë! Nisuni, tashti!

Natyrisht, nuk na vinte kaq zor nga njëri tjetri kur flisnim me lopët kështu. Donim si e si të venim në sektor pa u ngrysur, donim si e si t'i çonim të gjitha këto lopë në sektor. Kjo ishte detyra jonë. Ne na rrënqetet mishtë, kur mendonim ndonjëherë se këtyre lopëve mund t'u mbushej mendja e të merrnin pyllin që të gjitha. Ç'do t'u bënim ne? Ato ishin tridhjetë, kurse ne vetëm dy.

Nisën të na djegin nga djersa të gërvishaturat e para. Myskës filloi t'i mpikset gjaku në vazhdën e kuqe në faqen e majtë. Unë ndjeja tri-katër vënde që më digjnin.

Po afrohej një vah. Aty do t'i hidhним lopët në bregun tjeter të lumit. Në fillim ato hynë me qejf, zgjatën turinjtë drejt ujit e i frynin sipërfaqes së qetë me hundë. Po, kur arriten në mezin e rrjedhës, se ç'u tha mëndja të çanin nga e djaththa, të bënin nja 100 metër nëpër ujë e të dilnin prapë atje ku ishin. Prit e bërtit ne, ngjirru e çirru bjerë më not në ujë e dil prapë mbi të, ish e kotë; s'u mbushej mendja. I lamë ta çojnë në të tyren. Dualën prapë në bregun gjithë zall, nga barku u rridhte ujët e përqethnin lëkurën duke ndenjur si të menduara në diell. Pastaj i

futëm prapë në lumë e u desh një gjysmë ore e ca t'i hidhним matanë...

Kështu na kish ikur gjithë ajo mbasdite korrku. Ku numurohen peripecitë e pasosura? Çdo lopë, sado e urtë që të dukej, e bënte një proçkull, që ne na dëshpéronte e na nxirrte aq telashe. Dhe me këto andralla dielli pat perënduar pa u kuptuár aspak, në luginën e Matit kish rënë një muzg i freskët ngjyrë hiri e në majat e shkëmbinjve dukeshin ende njollat e kuqe të rrezeve të fundit. Nata na pat zënë në pyll. Ne e dimë se ç'kemi hequr në atë copë rrugë që bëmë me 30 lopë përpara, përmes drurëve dhe gëmushave. Po ja, pylli mbaroi, nga majat e maleve doli hënëza e qeshur, kopeja tashmë në livadhe sikur qe qetësuar, prandaj ne ndjenim atë gaz në shpirt e bërtisnim si kalamaj kot më kot: Ai-ai! Aji-aja! Këtë britëm e merrnin shkëmbinjtë në faqet e tyre të hirta gjithë gurë, ja jepnin njëri tjetrit dhe e tretnin nëpër natë si diçka të gëzueshme që donin t'ja dhuronin gjithkujt: Aj-ai! Aji-ajaaa!...

— A e di sa mund të jetë ora? — pyeta Myskën.

— Nja nëntë — më tha ai, duke parë qiellin e ndritshëm nga häna e gadi pa yje.

Bëra një llogari me mënd. Kishim për të kalluar lumin në grykën e Shkopitet. Kjo punë mund të na hante një sahat. Që nga gryka në sektor — një gjysëm ore. Aty nga ora dhjetë e gjysëm mund të arrinim.

— Do të jenë bërë merak, — i thashë Myskës.

— Po, tha ai. — Po sidoqoftë, ja, sikur e hoqëm pjesën më të vështirë. Këtu në grykë, përmes ujit, lopët s'kanë se ku të na shkojnë...

Rruga nëpër livadhe nuk zgjati shumë. Ajo preu djathtas e ra në shtratin e lomit. Përpara na doli, si një gojë e zezë dhe vigane, gryka e Shkópetit ku dëgjoheshin gurgullimat e ujit të lomit që çanin përmes shkëmbinjve të errët dhe të heshtur. Në këtë grykë s'hynte dot drita e hënës dhe ajo ishte kaq e errët sa të dukej sikur futeshe në një guvë të lashtë dhe të ftohtë. Po rrugë tjetër s'kish. Majtas dhe djathtas ngrihen shkëmbinjtë e thepisur njëqind, dyqind metra lart dhe na duhej të futeshim me gjithë kopenë përmes ujrale të lomit, që vënde-vënde të arrijnë gjer në fyt. Gryka është e gjatë pesëqind-gjashtëqind metra, e ngushtë dhe me brryle.

Lopët arritën në buzë të ujit dhe ndalën. Dhe ne ndalëm. E kishim kaluar këtë grykë dhe në mëngjes, shokët që hapnin tunelin atje në shkëmb na thërrisin e na përshëndesnin që lart, po tashти këtu ish një heshtje kaq e thellë sa të fuste një lloj frike ajo masë e zezë ujrash që dilte rrëmbyeshëm nga thellësitë e errta të grykës. Diku, atje midis shkëmbinjve, klithi një zog i madh që mori lart malit e kjo klithëm na futi drithërimën.

— Ej, ç'bëjmë? — tha Myska, duke e marrë veten i pari. — Haj Murgjinë, haj Baliskë! Ajs, ajs, ajs...

Ky zë kumboi fort, na e largoi atë frikë që na kishte zbritur në zemër e në çast sikur qemë gjallëruar papritur e qemë bërë gjithë sy e veshë. Kreu i lopëve nisi të hyjë në ujë duke turfulluar. Ato futeshin ngadalë, ngriheshin në këmbët e pasme e fillonin të ecnin duke zgjatur qa-

fën mbi sipërfaqen e ujit e duke lëshuar frymën të trembura.

— Hë? — ma bëri Myska, — s'ta mban? Opa, opa, — i hyri frika.

— Jo, i thashë unë, — s'më hyri frika dhe vura re se si Myska, para se të futeshim në ujë, u afrua pranë meje. Dukej se dhe atij i vinte një çikë frikë, po asnjeri s'donte ta jepte veten.

U futëm në rrjedhë e ndjemë se ujët na lagu gjunjët, belin dhe na arriti gjer në sjetulla. Llapashitjet e ujit merrnin tinguj misteriozë në ata shkëmbinj gjithë forma të çuditëshme që nxinin e ngriheshin viganë mbi ne.

Myska u afrua më pranë meje, diku u kapëm dorë për dore e nisëm të shtrëngoheshim fort. Ujët na ngjante më i thellë, kishim përshtypjen se do të binim në ndonjë gropë, prandaj herëherë lëshoheshim me not e prapë kapeshim për dore. Para nesh dukeshin qafat e zgjatura të lopëve, që çfryrin mbi sipërfaqen e ujit e këto çfryrje të ngjanin si frysëmarrje të thella të ndonjë përbindëshi, sepse jehonin gjer tej grykës së errët. Po ne u mësuam dhe dalngadalë sikur na u hoq ajo frikë që na kish pushtuar aty pak më parë. Lumi nuk kish ndonjë gropë të thellë, ai shpendi i natës nuk dëgjohej më dhe sytë tanë filluan t'i shquajnë gjithmonë e më qartë gurët, shkëmbinjtë, bile dhe trasenë e rrugës atje lart.

Po në mezin e kësaj gryke, ku ujët arrinte gjer afër fytit, lopëve se ç'iu tek e u kthyen të gjitha mbrapsht. Ato kalonin përmes nesh, çfryrin e nxitonin dhe as që pyesnin për britmat tonë. S'kish gjë më të dëshpëruar, kur shikoje gj-

thë atë kope që kthehej prapë. Myska u lëshua me not tundëte duart, bërtiste e qante nga inati. Po lopët shikonin të tyren. Ato dualën në zall. u mblozhën kokë më kokë, ndërsa kullonin çurg dhe mbllaçteshin pa e prishur gjakun fare.

Dhe ne dualëm e u ulëm në ca gurë. Rrobet na qenë ngjitur mbas trupit, ujët na kullonte gjer poshtë e ndjenim të na i përqethëte mishrat një erë e freskët që vinte nga gryka. Ishim kaq të dëshpëruar sa nuk flisnim fare. Ç'të bënim? T'i linim lopët aty e të shkonim në sektor për të lajmëruar shokët? Po si mund ta linim kopenë aty? A kështu zbatohej detyra!? Shokët tanë e kishin kryer detyrën e tyre. Ata kishin punuar gjithë ditën, kishin rrahu shkëmbinjtë me varre, kishin hapur vrima me barromina, i kishin mbushur me dinamit dhe i kishin shpërthyer. Dhe ne ishim rraskapur, ishim lodhur e këputur fare duke rendur mbas lopëve, fundi dhe kjo ishte një detyrë e vështirë, po s'e kishim çuar gjer në fund. Natyrisht, këto s'ja thoshim njëri tjetrit po i mendonim ashtu vetë më vete, duke ndenjur pranë lopëve të qullur gjer në kockë e ëme një barrë dëshpërimi në zemër. Këtë dëshpërim e ka ndjerrë medoemos çdo njeri që i është ngarkuar me besim një detyrë dhe ai s'e ka kryer dot.

— Sikur të shkojmë e të thërrasim dy-tri veta në sektor?! — i thashë Myskës.

Ai s'u përgjegj menjëherë, kish varur kokën e mua m'u duk sikur po dëneste në heshtje. Ku ta dish? Mbase vërtetë dëneste, sepse këtë e provoja dhe në veten time. Që nuk më shkonin lot, këtë e bëja nga turpi sepse aty pranë ishte Myska.

— Jo! — tha ai më në fund, me një fije zëri që mezi i doli nga gryka. — Ata kanë rënë të flenë, janë lodhur gjithë ditën...

Dhe u çua. Shkundi krahët, që kishin zënë t'i ngrinin nga të ftohtit dhe më tha:

— Ç'presim? Këto çamarroke kështu e kanë. A e mban mend si u kthyen tek vau? Po pastaj e kaluan ama. Duhet njëri nga në të eci përpara. Si tha këto, më ktheu kurrizin dhe hyri në mezin e lopëve.

— Hajt Murgjinë! Hajt! Ja, dhe një çikë e arritëm.

Zërin se si e kish, të lëngshëm po dhe me kumbime të ashpra. Unë e kuptoja luftën që bë-hej në zemrën e tij. S'kish turp më të madh për ne po të mbeteshim aty.

Ai u binte me shuplakë lopëve lehtë në vithe, i shtynte drejt ujit dhe ato nisën të futen prapë në rrjedhë varg e varg.. Pastaj m'u kthye mua që rrija në këmbë e shikoja si i shtangur nga gëzimi. Më bërtiti:

— Ec, po ti ç'rri atje si hu?

Unë renda.

— Shko në krye dhe folu lopëve, më tha.

Kjo «folu lopëve» se si më tingëlloi. Sikur më thosh: «Ik e jepu zemër. Dobarem thuaju se s'ësh-të ndonjë qamet pér ta kapërxyer këtë grykë».

Vajta në kreun e karvanit. Lopët tani sikur ecnin më me guxim. Mbas meje vinin dy-tri kokë duke çfryrë e më pas akoma dukej e gjithë kopeja që ecte e ecte... Tani s'ndjenja as frikë nga errësira, as frikë nga gropat.

Kur arritëm në vëndin që u kthyen, lopët

ndalën prapë e nisën të çajnë nga e djathta. Donin të bënin mbrapsht sérish, po Myska u hodh me not e u preu rrugën duke bërtitur:

— Oha, Murgjinë, oha Baliskë. Ajs, ajs, ajs...

Zëri i tij këtë herë ish i fortë dhe lopët, si ndenjën një hop si të topitura, vazhduan të vinin mbas meje. Atëhere Myska nisi të bërtasë orë e çast me një gëzim të papërshkrueshëm: — Ajs, ajs, ajs. Përpara.

Shkëmbinjtë e errët dhe të heshtur gjëmonin nga ky zë që merrte përpjetë honeve dhe tretej dalngadalë. Lopët tanë ecnin, ecnin...

Papritur nisi të dukej fundi i grykës, ai s'ish më tepër se 50-60 metra më tutje. Atje ne vumë re tre-katër fenerë dhe dëgjuam dikë që thirri:

— Ej, Myskë. Ju jeni, ore?

— E-hej, u përgjigj Myska. — Ne jemi, ne!

Nga sektori kishin dalë nja dhjetë vullnetarë të brigadës sonë për të na kërkuar. Ata sa do të futeshin në ujë, po dëgjuan zërat tanë dhe vendosën të na prisnin. Ora mund të ish nja njëmbëdhjetë. Ne dualëm më në fund nga gryka e ata na thanë:

— Po ç'u bëtë ore? Prit se vini tashti, prit se vini pastaj. U bëmë merak. Po hë? Ama qënki bërë...

Lopët u futën në rrugën e sektorit, kurse ne të gjithë, me fenerë ndër duar, shkonim mbas tyre. Dicka jashtëzakonisht e bardhë dhe e ngrohtë kish vërshuar në zemrën time dhe të Myskës. Ish-te gëzimi i fitores. Kjo ishte klasa e parë e shkollës së jetës, ku ne mësonim të mos tërhiqeshim përballë vështirësive.

Myska u mundua tē veshë këpucët, po ato qenë lagur, çorapet i ishin bërë ujë dhe ai hoqj dorë nga ky mundim. Kish mbetur pak prapa dhe na arriu duke rendur. Tani s'ndjehej më ajo erëza e mirë e lules së blirit. Këtu vendi ishte shkëmb e gurë dhe ne ishim tē gëzuar. Hëna ndriçonte ëmbël luginën, pyjet atje lart dhe ujrat e rrëmbyeshëm tē Matit që rrëshqisnin drejt perëndimit plot melodi tē mbytura.

Myska bërtiti përsëri:

Afrohej mesnata dhe lart mbi male, ku kash-
ta e kumtrit shtrihej si një urë e argjendë mbi
majat e tyre, u dëgjua jehona e gëzuar:

— Ai-ai! Aji-ajaal...

DREJT MAJËS

Maqina ndaloj në anë të qytetit e, për këtë më duhej të bëja gjithë atë rrugë më këmbë. Kisha udhëtar sipër në karroceri. Ishte verë. Rrugës kishte shumë pluhur. Çdo makinë që kalonte nuk na e kursente një pudrosje të lehtë, ndaj dhe pa u parë në pasqyrë, sikur e kisha përpara vreten timë ashtu gjithë pluhur. Isha i mallëngjyer. Kisha një vit të tërë pa shkuar në shtëpi. Pushimet e janarit i kalova në Dajt. Më kish marrë malli për gjithë njerëzit e shtëpisë, por sidomos për mamanë, më e vjetra në familje, dhe për më të voglin, Ilirin, djalin e vëllajt. Këta të dy i kisha në mëndje çdo ditë, mbasë dhe çdo orë. Një ndjenjë e çuditëshme kjo e mallit për më të vjetrit dhe për më të vegjilit në familje. Ndofta ndaj na tërheq aqë shumë lindja dhe perëndimi i diellit!?

Në një qoshe, kur sapo lashë valixhen, hodha një vështrim rreth e rrotull e, me dorën tjetër u mata të ngrihesha e të nisesha, vë re, se drejt meje po afrohej Besniku, një shok i kursit. Ai nuk mundi të vinte në aksion, se dy ditë para nisjes i ndodhi një fatkeqësi. Vetë dekani e thirri në zy-

rë, për t'ja komunikuar. Na erdhi keq të gjithëve, sikur të na kish ndodhur vetë nevë. Ishte nga ata që e donim të gjithë. Ja, tani ai po vinte drejt meje. Unë nuk e takova dot as kur u nis për në shtëpi. Nga një anë më erdhi mirë që ndodhi kështu. Sa të vështirë e kam në të tilla raste! Nuk di as se ç'të bëj e, as se ç'të flas. Prandaj dhe tani nuk më erdhi mirë që e hasa mbudhë. Sa i gëzuar që isha, por ja në çast gjithshka u ndryshua. U duk sikur gjithë ai gëzim e mallëngjim u shkri, humbi diku. Ç'do t'i thosha? Më ra në mëndje një gjë; t'i shmangesha, por e kuptova se ashtu nuk veproja drejt. Tek e fundit e kisha shok. Ja, më pa dhe ai. U sul drejt meje me vrap duke u munduar të më buzëqeshte. E kuptova se për këtë iu desh mundim. U përqafuam. Ndjeva se sytë m'u mbushën me lot. Ai më pyeste, siç dukej, me ato përshëndetjet e zakonshme, por unë asgjë nuk dëgjoja e nuk merrja vesh, vetëm nxirrja një «mirë» të thatë nga goja, me shumë vështirësi, sa herë që pyeste. Kurse unë nuk guxoja ta pyesja. Nuk dija se ç't'i thosha. Pas pak e mora vreten dhe vetëm ahere nisi midis nesh biseda e zakonshme.

— Hë, po ç'na thua, si shkoi aksioni?

— Mirë — i thashë.

— Ç'bëtë, a u lodhët? Sigurisht pak; ku jemi mësuar ne me punë të tilla. E di sa keq më ka ardhur që s'isha, por ç't'i bësh...

Në fillim më erdhi mirë që iu shmangëm si pa dashur kësaj teme, por nuk i shpëtova dot. Pasoi një heshtje e gjatë.

— S'ke ç'i bën, i kajeta këto. Për njeriun janë të gjitha — munda të bëlbëzoj me vështirësi,

duke zbatuar më tepër një formulë që e kisha dëgjuar dhe nga të tjerët në të tilla raste.

— Po hë, folë! Jam shumë i etur të di çdo gjë, çdo gjë, dhe me hollësi. Kam lexuar me interes gjithshka që është botuar për ju në të gjitha organet. U mata kaqë herë të nisesh, por nuk mund ta lija nënën vetëm ato ditë të rënda përtë...

Pasoi përsëri një heshtje e gjatë.

— Hë de, folë — theu heshtjen ai — jam i etur për gjithshka, dua të di gjithshka që lidhet me aksionin, me shokët e mi, me ty. Gjithshka, më kupton, apo jo? Sa kam vuajtur shpirtërisht këtë muaj, se veç asaj që ndodhi, dhe mos ardhja në aksion më ka munduar shumë. Prandaj folë, folë sa më shumë...

Në fjalët e tija nuk e kishe zor të dalloje sin-
queritet dhe ngrohtësi, por një ngrohtësi të tillë që
mua më preku së tepërmë.

— Po, do të flas — i thashë unë — po tani,
nuk është as koha as vendi, apo jo? — shtova du-
ke i buzëqeshur. — Ne do të takohemi.

— E po shumë mirë; gjatë kësaj kohe siste-
moi dhe më mirë ato që do të më thuash, kom-
pozoi, planifikoi...

Qeshëm lehtë që të dy. Pas pak u ndamë.
Unë isha i çlodhur mirë dhe pjesën e rrugës që më
mbeti, e bëra si të thuash me një frymë. Në shtë-
pi më pritën ndryshe nga herët e tjera.

— Ua, sa qënke nxirë, mor t'u bëftë nënia! —
më tha mamaja, sapo më pa e m'u hodh në qafë,
— dhe me shëndet, mashalla, shumë mirë qën-
ke...

— Xhaxhi, uuu xhaxhi, ja xhaxhi... — nisi ligjërimin Iliri.

Puthjet e përqafimet vazhduan gjatë. Mbas kësaj vërshoi lumi i pyetjeve. Dhe këta, tamam si ai shoku i kursit donin të dinin gjithshka me hollësi. Kjo më ndodhi edhe të nesërmen kur takova të njohur të tjerë. Kështu vendosa t'i shkruaj kujtimet e mia.

Kapitulli i parë

Natën e fundit, sheshi para tendave ku flinim, i mbushur plot e përplot me vullnetarë, sa që s'kishe ku të hidhje mollën, dukej sikur qeshte e gëzohej. Asnjë student nuk shihje të mërzitur. Dhe deti, që atë natë ishte i qetë si asnëjherë tjetër, të jepte përshtypjen sikur merrte pjesë në gjëzimin tonë. Aty plaste një e qeshur e fortë; më tej disa ja kishin marrë një këngë popullore, të tjerë ndiqnin me interes një histori që po u kallzonte shoku i tyre. Kjo ndodhë zakonisht ose kur nuk kish vallzim, ose kur ata të orkestrës e zgjasnin pjesën më tepër se ç'duhej e, këta, për të mos u mërzitur, nisnin programet e tyre.

Ne kishim zënë vënd aty nga radhët e mezit, në të djathtë të grumbullit të madh që ndodhej karshi orkestrës. Në mes ish ulur profesor Petrua, si më i vjetri në gjithë brigadën. Gjatë aksionit atë e kishim edhe në vend të prindit. Ishte në prag të pesëdhjetave. Fjalët i kish të shtrenjta; punonte me sa fuqi që kish e rrallë e shihje të ulej. Çdo fjalë të tij e dëgjonim me vëmëndje, tamam si në shkollë, gjë që nuk ndodhë me këdo. Këtu

studentë e pedagogë ishin njësoj: quheshin vullnetarë. S'ishte për t'u çuditur kur një pedagog, përtë munguar qoftë edhe një orë në punë, i merrte leje studentit, komandant i brigadës, të cilin vetëm para një muaji e kishte pasur përballë tryezës duke i kërkuar llogari në provim.

Pranë profesorit në të majtë, ish ulur Andoneta, apo Neta, siç i thërrisnim të gjithë shkurt. Ishte më punëtorja e brigadës, e vëtmja që në të punuar, konkuronte edhe me djemtë më të zotë. E donim të gjithë si motër. Gjithmonë do ta shihje të qeshur e në bisedë qysh në fjalët e para, të bënte për vete nga që e kuptoje se pas atyre fjalëve që thosh, nuk fshihej gjë tjetër, siç ndodh zakonisht me vajzat, në mos edhe me djemtë e moshës sonë. Biseda me të na tërhoqte qysh në fillim, por këtu nuk ish ai interes i zakonshëm që ngjallin femrat nga vetë natyra e tyre. Përkundrazi, ajo si në punë, si në bisedë afrohej më shumë me ne djemtë. Kish diçka të ngrrohtë e të sinqertë në gjithë veprimet e saj. I pëlqenin më shumë bisedat teorike për shoqérinë, dashurinë, miqësinë, bille dhe për lëndët e ndryshme e, ndofta kjo që kontradikta e vetme me të, me që biseda të tilla nuk para na pëlqenin aqë shumë ne të tjerëve. Dhe tani, sado e çuditëshme që të duket, ajo po diskutonte me profesorin për një ndodhi të vitit të kaluar, kur po jepte provimin e fundit.

Nga krahu tjetër i profesorit ish ulur Xhezua, një djalë trupmadh, muskuloz e punëtor, por aqë naiv sa që nuk e merrte për shaka po t'i thoshe se me të kish rënë në dashuri filan vajzë që punonte në brigadën tjetër e, që as e dinte fare se

jetonte një Xhezo diku në këtë botë. Të besonte për çdo gjë që do mund t'i thoshe, në se nuk do qeshje më von, ose ta sqaroje se e kishe pér shaka. Nga ana tjetër dhe ai të fliste me zëmër të hapur pér çdo gjë. Sidoqoftë ne të gjithë e donim dhe atë, jo më pak se Netën. Ishte kjo arësyjeja që ne zakonisht me zor e mbanim të qeshurën që na ndillte me ato që bënte e që thoshte.

Në krah të Xhezos rrinte romantiku i klasës, Pëllumbi, tip i qetë e i shtruar në të folur, sa që ja kalonte edhe një plaku. Gjatë leksioneve ndodhët që të rrinte gjithë orën pa lëvizur fare, 'me sy-të mbërthyer në qafën e shokut që kish pérpara. Kur e shihje pér herë të parë, të dukej sikur po mendohej të të thoshte diçka, por pastaj e kuptoje shpejt se prisje më kot. Dhe tanë në mbrëmje qe nga të paktët që rrinte më tepër serioz e më të rrallë i dalloje në fytyrë ndonjë buzëqeshje, që fekste si drita e një fari natën në breg të detit. Shkruante dhe poezi. Pér gjithë këto, në mbrëmjen e vitit të ri, një shoku ynë i kursit, duke iu drejtuar letrarëve me një poezi satirike, thoshte:

*Mos u bëni si poet Pëllumbi,
Që nga poezia toruan e humbi!*

Ngathtësia e tij çfaqej edhe në punë: rrinte i mbështetur në bisht të lopatës, me vështrim të humbur diku, deri sa gjerrmonte tjetri. Kazmës e lopatës nuk ja thoshte, sa penës, por ja falnim, me që dhe këtu muza e vizitonte herë pas here gjatë ditës.

Pas Pëllumbit vinte treshja e famshme: San-



dri, Bashkimi dhe Perlati. I gjeje kudo bashkë. U pëlqente muzika dhe kohën e lirë e kalonin ose duke dëgjuar muzikë, ose duke kënduar të tre. Ishin bërë të njojur sidomos me programet e pasura që jepnin në pushimet gjatë orëve të leksionit. Perlati këndonte, Bashkimi i binte bankës ose tavolinës (sipas rastit), kurse Sandri mbante melodinë duke shoqëruar herë njërin e herë tjetrin. Me ta ish bashkuar edhe Verdi i klasës, ose siç i thërrisin të gjithë, Xhuzezia. Emrin e kishte Guxim, por rrallë e dëgjoje t'i thërrisin me këtë emër. I pëlqente së tepërmë muzika klasike. Vëtë i binte shumë mirë, me aqë sa mund ta çmonim ne, violinës dhe kitarës. Kur i kishte këto në dorë, s'ta prishte qefin kurrë për çdo këngë e melodi që t'i kërkoje. I hollë nga trupi, me hundën pak si shkabë, me duart e gjata e me gishtë rintjtë akoma më të gjatë, ndofta më shumë i afrohej Paganinit, por ja që i thërrisnim Xhuzepe. Fundja emri s'na prishte shumë punë. Edhe në aksion Xhuzezia mundohej të na kënaqte. Në fillim e merrte edhe në punë violinën, por me që kur fillonte t'i binte gjatë pushimit, i vidhëtë punës vazhdimesht nga pesë e nga dhjetë minuta, komandanti i kish thënë që mos ta merrte më dhe ky nuk ja kish prishur qefin.

Para tij qe ulur heroi i aksionit, Shabani, i paarritshëm në hapjen e taracave. Nga mosha ishte ndër më të mëdhenjtë në kursin tonë; kish punuar katër vjet arësimtar, por me punën në aksion të jepte përshtypjen sikur qe marrë vetëm me bujqësi. Dhe në biseda dukej që ishte nga fshati: e hiqte veten si specialist për krasitjen e pemëve dhe në përgjithësi rrëth këtyre ta sillte

fjalën. Në favor të kësaj fliste dhe fytyra e tij e gjerë, sytë e mëdhenj, e nofullat e trasha. E donim të gjithë e asnë nuk zemërohej kur bërtiste e shante ashpër, ngandonjëherë edhe duke i kaluar kufijtë. Kishte një të keqe se, kur qe puna për të marrë ndonjë masë, nuk qe kurrë dakord që të dënohej fajtori. «Epo njerëz jemi, — thosh — dhe gabojmë.»

Në krah të tij qe Mujua me Katerinën. Kësaj gjithë ne i thërrisnim Rinë, por njerit i pëlqente t'i thoshte Kati. Ky ishte Mujua. Ata, qysh nga mezi i. vitit të kaluar, rrinin gjithmonë bashkë. Për këtë, sa herë që na jepej rasti, kontribuonim edhe ne. Dukej, sikur dikur dhe diku qe marrë një vendim për këtë çështje, që zbatohej në hesh-tje nga të gjithë ne. Dhe në punë punonin së bashku: Mujua me kazmë e Rina me lopatë, por më shumë shikoje Mjon duke punuar me të dyja. Këtu sikur na e kish prishur pak qefin Rina. Ish nga fshati e me punë të tillë qe marrë më tepër se Mujua, që ish lindur e rritur në qytet.

Si gjithmonë dhe në aksion, Marjeta, Shpresa dhe Lumturia nuk ndaheshin nga njëra tjetra. Bashkë qenë ulur dhe në këtë mbrëmje. Shpesh na dukej sikur ato edhe ngjanin me njëra tjetrën. Trupvogla, të urta e punëtore si në mësim e në punë. I donim që të gjithë si motrat tonë e sillëshim me to pa ndruajtje fare. Se ç'po u tregonte Mersini e po shkuleshin së qeshuri. Qeshte edhe Mersini. Le që atë gjithmonë duke qeshur e shikoje. Qeshte sa mundte, vënd e pavënd. Pas tyre vinin me radhë: Sotiri, që siç e kish zor të fillointe punën, ashtu edhe nuk dinte të pushonte; Sofia, që duke bredhur nga një front pune në

tjetrin, më tepër nxiste të punonin djemtë e brigadës se sa punonte vetë; Marku, më interesanti i klasës: kokëfortë, por edhe punëtor; nuk hiqte dorë nga ajo që thosh, sikur të përmbysëj bota; Xhemali, që dinte përmendësh gjysmën e poezive që kish lexuar, profesor Veliu, që në punë e në bisedë nuk shquante nga studentët. Ganiu, komandanti i brigadës, kish normë të vogël se duhej të kontrollonte gjithë kompanitë, por ky realizonte zakonisht mbi dy norma. Kjo na shtynte për të punuar më tepër se çdo urdhër që mund të na jepte. Në muhabete kish humor e të ndillte vëmëndjen qysh në fillim: lexonte shumë e, qe nga të rrallët që në provime futej pa frikë fare.

Të gjithë qeshnin, ishin të gëzuar e të kënaqur. Nata e fundit sikur i kish kthyer të gjithë në një mëndje. Duke i parë kështu, sepse m'u kujtua fillimi i punës, dita e parë kur erdhëm. Kish nga ata që qeshnin edhe atëhere si tani në fund, bile kështu qe shumica, por kish dhe nga ata që nuk u qeshte ftyra. Një hije e rëndë dukej sikur ua kishte mbuluar ftyrën. Ndaj në natën e soçme, kish diçka të gëzueshme, të gjallë e optimiste që të bënte për vete. Por dhe fillimi me ato kontrastet e forta që kish, nuk ish më pak interesant.

Kapitulli i dytë

E përpjjeta për tek vendi i ri i punës na lodi së tepërmë të gjithëve. Kishim punuar dy orë në një vënd tjetër, por atje e mbaruan çpyllëzimin. Një ditë më parë kishim djegur pyllin. Mbetej prerja e drurëve të padjegur, punë kjo e lo-

dhëshme. Veç kujdesit që duhet të kesh vazhdimi shët se mos të të shkelë këmba në ndonjë vend ende të pashuar, bëhesh dhe pis sikur ke punuar në qymyr. Të gjitha këto do t'i pranonim, sikur me normë të kishim dalë në rregull. Por dhe me këtë ishim keq. Një pjesë ja hidhnin fajin vëndit të punës; një pjesë tjetër fillimit, si pa eksperiençë që ishim, kurse ata të shtabit i binin shkurt: nuk është punuar në rregull.

Ja, tani arritëm tek vendi i ri, me shpresë se këtu do të ndryshonte puna. Para nesh shtrihej pylli, të cilit do t'i vinte fundi prej duarve tonë. A do të na lodhte dhe ky si ai i pari? Këtë pyetje i drejtonim të gjithë vetes dhe pyllit, por më kot prisje përgjigje: qe vapë e madhe dhe nuk lëvizte as edhe një fletë.

— Këtu kemi për të bërë qejf, — tha Vasua që e kish për traditë të hapte emisionet — apo s'qënka dhe i dendur: as plumbi nuk kalon në të.

— Jo o vëlla, nuk çpyllëzohet ky! — tha dhe Rexhepi, mbasi qe ngritur dhe i kish hedhur një sy pyllit. — Po pse xhanëm, ku na e gjejnë neve vëndin më të keq.

— Se mos i ke parë ti frontet e tjera, — ja ktheu pa lojtur nga vëndi Shabani që qe pranë tij.

Ishim ulur për t'u çlodhur pak.

— Çohemi shokë, se vëndi nuk na thotë kurrrë çohuni! — tha Ganiu duke marrë rrugën drejt pyllit.

Pas pak u futëm të gjithë në pyll. Sa vinte, kalimi në të bëhej edhe më i vështirë, derisa më në fund thuase u bë fare i pamundur. Nuk mjaf-tonte që pemët ishin shumë të dendura, por ndër to qenë ndërthurur ferra të shumta e qe formuar

kështu një pyll i tillë që dhe pér të ecur e kishe shumë të vështirë, e, jo më pér të punuar.

— Pylli i Sodresë¹⁾ — tha Xhemali — éshtë duke na prirë Goveni.

Shpërthyen të qeshura, megjithëse nuk qe koha e tyre. Të gjithë po e kuptonin se këtu do ta kishim edhe më të vështirë, ndai edhe nuk po fllisnim. Duhej të arrinim patjetër në mes të pyllit. Nga ana e poshtëme po punonte një brigadë tjetër. Të dy krahët anësorë qenë gjithashtu të zënë. Sipër nuk mund të filloje se ishte shumë larg. Kështu depërtimi në mes të pyllit qe i domosdoshëm. Ecja sa vinte po ngadalësohej.

— Gani, éshtë e kotë të vazhdojmë kështu, — i thashë unë.

— Po si thua ti? — më pyeti duke ndaluar.

— Të tjerët le të rrinë njëherë pér njëherë. Unë, ti, Shabani, Sotiri e ndonjë tjetër, le të lëshohemi në katër pesë drejtime, sa të hapim rrugën pér tek vendi i fillimit të punës. Të tjerët të vinë më vonë. S'kemi se ç'bëjmë.

— Uuu! — u dëgjua një e uluritur vajze nga mezi i kollonës së gjatë. — Obobo, ç'i punova këmbës!

E njoha. Qe zëri i Netës. Të ankuarit e vajzave nuk na bënte më përshtypje. Dhe një gjëmb i vogël t'u hynte në këmbë ose në dorë, e ngrinir zërin deri në qiell, por me Netën nuk ndodhë kështu. Ndaj na tërhoqi vëmëndjen.

— C'ke Neta? — pyeti me zë të lartë Ganiu.

1) Pylli i Sodresë — një nga vëndet ku zhvillohen ngjarjet e romanit «Viti 93», të Hygojt. Goveni, një nga personazhet kryesore.

— Jo, asgjë! — tha ajo. Qe ulur e tē tjerët e kishin rrethuar.

— Shpejt sanitarja se e ka vrarë keq! — bërtiti njëri.

— Shpresë, ku je, ku ke humbur kështu. Ptu, tē marrtë dreqi, as për kaqë gjë s'të ka njeriu.

— Hë, ja erdha dhe ti, nuk sheh se mezi po kalojmë! .

— Mos ja vërë re Rexhepit, ashtu e ka ai — i tha Ganiu — shko shihe, po qe shumë keq na lajmëro dhe neve...

U ndamë në drejtime tē ndryshme. Të tjerët u ulën. Morëm nga një kosore në dorë e filluam tē çanim përpara. Unë mora më tē sipërm. E kisha shumë tē vështirë, por dhe tē tjerët nuk besoj se e kishin më tē lehtë. Në fillim fusja bishtin e kosores, e luaja pak majtas e djathtas, sa për tē futur njérën këmbë. Me duar pastaj i hapja vendin trupit e kaloja një hap më tutje. Herë-herë ecja mbi pemë, kur qenë shumë tē mëdha se, po t'i shkurtoje, donin shumë kohë. Puna nuk priste. Mund tē kish kaluar një orë qysh kur filluam depërtimin e akoma s'kishim vajtur tek vendi i punës. Ndaj duhej sa më shpejt. Ku mundja, përdorja kosoren, por dhe kjo qe shumë e vështirë.

Papritur përpara më doli një përrua i vogël. Aty vendi qe shumë i thellë. Ja hodha fajin fatit tē keq. Gjithë ajo punë më shkoi kot. Duhej tē kthehesha prapa se aty kalimi ishte shumë i vështirë. Me një kërcim tē fortë e kaloje, por këtë mund ta bënin vetëm një pjesë e djemve. Po vajzat? Kjo më shqetësoi së tepërmi, por nuk qe koha për tē menduar gjatë. Më lindi një ide. Afër meje qe një lofatë e trashë. Nisa ta pres pa

humbur kohë. E shtrina mbi gropën që kisha para, gjë që më hëngri shumë kohë nga që pentagonin gjethet e tjera. Degët e majës u mbësh-tetën fort mbi anën tjetër e kjo më kënaqi shumë. Qëllimi u arrit. Lëshova dhe ca lofata të tje-ra e gjineshtra mbi të, si për të gënjer syrin dhe kalova matanë me lehtësi. Vazhdova më tej. I bëra një zë Ganiut sa pér t'u orientuar. Isha në rregull. Dhe për pak do të isha në vendin e punës. Në secilën nga rrugët që po hapnim ne, do të kalonin skuadra të ndryshme të brigadës sonë. Do të fillonte ecja përpara në drejtimin horizontal, sa të takoheshim e pastaj do të vazh-donte zbritja poshtë.

Si shenjë kishim një ulli që ndodhej në bregun përballë, nja katërqind metra larg nesh. Hipa mbi degët e pemëve pér ta parë. E kisha arritur drejtimin.

- Gani!
- Ooouuu!
- Arrita, po ti si dukesh?
- Ja dhe unë në mbarim jam! Shaban, po ti gati?
- Gati!
- Hej, profesor Petrua! Të nisen pér këtu të gjithë! Duke filluar nga unë me radhë sipas kompanive e skuadrave!

U ula sa pér të marrë frymë. Isha lodhur shumë. Këmishën, që e vesha pér të mos më çpuar ferrat e degët, e kisha pér ta shtrydhur nga djersa. Mendova ta nxjerr, por trëmbesha mos ftohesha. Por dhe të nxehtit po më mbyste. E hoqa. Fshiva me të dhe fytyrën e sikur m'u freskua pak lëkura.

— Hë, a u lodhe? — më tha Neta.

— Vdiqa, veç fryma më ka ngelur, — i thashë. — Po ty si t'u bë këmba? Po ç'pate ti, ne të mbanim si më të fortën?...

— Po hë, thua dhe ti: e shpoi gomën e kë-pucës dhe ma ka bërë gojë nga poshtë, dreqi i gjëmbit. More, po do të ftohesh, shiko si merr frymë?! Na vishe, ose hidhe krahëve! — dhe më hodhi trikon e saj që e mbante në dorë.

— Lëre moj se nuk na gjen gjë neve. Ikë se do të ta bëj pis!

— Ama, ç'thuas dhe ti, vishe ore tanë e lëri llafet!

E hodha krahëve. Kishin ardhur të gjithë të skuadrës sime. Duhej filluar nga puna. U ngrita.

— Ja, këtu do të fillojmë!

— Po pse punohet këtu? — nisi të ankohet Bardhyli.

— Hë se atje ku ishe u shkrite në punë zotrote, e këtu s'të punohet — ja pat Neta.

— Jo, këtu nuk punohet vërtet — tha Mersini, ne mezi erdhëm o derëbardhë e jo më të punojmë!

— Mirë ti mos puno, por këtë kemi, punohet, s'punohet. E ç'ta zgjatim?

— Bravo Simurden¹⁾ — ma ktheu mua e filloj të qeshë.

— Po ti, «njeriu që qesh»²⁾ — ja prita unë. Qeshën dhe të tjerët. Filluam nga puna, por

1) Simurdeni — një nga personazhët kryesorë të romanit «Viti 93».

2) «Njeriu që qesh» — roman tjetër i Viktor Hygojt.

jo të gjithë. Vend i mezi na merrte edhe për të ndenjur. Disa as nuk mund të uleshin edhe sikur të donin. Drurët e prerë duhet t'i hidhnik pas, por kjo qe e pamundur në kushte të tillë.

— Le t'i hedhim poshtë tanë në fillim, pastaj i ngrejmë përsëri!

— Ama, punë dyfishe...

— Ndryshe nuk ecet!

Duhet të përdorje sopatën ose kosoren, por drurët e dëndur nuk të linin për asnjëren. Një pjesë të degëve i thyjeja me dorë, sa për të fituar pak hapësirë. Herë të tjera i bija vertikalisht. Nisa të pres një të trashë. Duhet të merrja fuqi dhe harrova që s'kisha vend. Shtriva krahët por sopata më takoi diku pas. Më dukej sikur dikush ma mbajti me dorë. Më erdhi ta flakja nga inati. Por puna s'priste. Ajo duhej prerë patjetër. Fillova ta pres mengadalë, me sa të mundja. E kuptova se qe e pamundur. Duhej më parë të hapja vendin së sipërm. Pastaj iu ktheva përsëri drurit të trashë. Luftoja në dy fronte: luftë me pyllin, por dhe luftë me vvetveten, luftë nervash. Kjo e dyta ishte edhe më e vështirë akoma. Duhej durim i madh. Pakujdesia më e vogël mund të kushtonte një dorë ose një këmbë.

Pas pak u hap vend pune për të gjithë. Degët që kishim hedhur përpëra po na pengonin së te-përmi.

— Sa të mundni degët i hidhni pas, tashti! — u thashë shokëve.

Filloi pak a shumë të përparonim, me që sopatën dhe kosoren mund t'i rregulloje si të doje. Na dukej sikur bashkë me këtë filluam të marrim

edhe frymë në rregull. Vajzat ende s'kishin nisur nga puna. Disa qenë ulur dhe po bisedonin.

— Hej ju, o motra! Pa nisni e hiqni këto që presim ne njëherë, se boll na qëndruat më këmbë, — u tha Vasua, me një mënyrë të tillë që nuk e merrje vesh në fliste seriozisht apo tallej, mënyrë kjo e zakonshme për të.

— Hë, çohuni tani, merrni këto degët e i hidhni andej lart!

E para ja nisi Liliana. U afrua tek unë dhe nisi të m'i marrë drurët që prisja, nga dora, ose ndofta unë fillova t'ja jap asaj në dorë.

— Largohu pak më tutje se s'i zihet besë kësaj, sëpatë është — i thashë unë.

— Hë se nuk na gjen gjë, po jepi, — më tha ajo.

Fliste gjithmonë duke buzëqeshur pak lehtë e unë nga që kështu e kisha parë qysh në fillim kur isha njobur me të, nuk e merrja dot me mend në se mund të nxehet ajo ndonjëherë. Fliste në mënyrë të tillë, sa nuk mund t'i kundërshkoje.

Me të për herë të parë u njoha këtu në ak-sion. Në fakultet e kisha vënë re si fytyrë. Ishte nga ato që binte në sy. Pamja e jashtme e saj dukej sikur kish diçka të ngjashme me atë që bënte e që thosh.

— Jo, mo! nuk punohet këtu, ju thashë unë — foli Bardhyli dhe e hodhi kosoren për tokë. Nuk i vuri veshin njeri, por dhe ai pa e prishur gjakun fare u ul në një hije të vogël pak më sipër. Kish filluar të më dilte nga zemra fare; por se si nuk më vinte mirë dhe t'i flisja. Pranë tij ishte duke punuar Xhezua, që nuk ja përtonte punës,

kudo që të qe. Ishte dhe i fortë nga trupi, por dhe punonte me gjithë shpirt e, kjo e ndihmonte më shumë, me sa kuptoja unë. Filloi të priste edhe në vendin e Bardhylit.

— Bardhyl, ku the ti se s'punohet, këtu mo? Shiko!

Nisi t'i mëshojë kosores me sa fuqi që kish. Drurët dhe ferrat rrëzoheshin sikur të qenë bar.

— Ja kësaj i thonë punë! — tha Mersini. Nisëm ta vështrojmë pér një çast të gjithë.

— Do jetë kosorja e mirë, — tha Bardhyli e u çua nga vendi.

— Ku e ke tënden, hidhe këtu!

E provoi me gishtin e madh në presë e i tha:

— Po kjo është dhe më e mirë, a t'u mbylltë dera, ja shiko këtu!

Djersa nisi t'i shkëlqejë në gjithë trupin e xhveshur e nga balli nisi t'i rrjedhë poshtë.

— Po pse kështu të punoj unë, o, pse pér t'u çkallmuar kam ardhur a? Jo ore ne nuk erdhëm pér t'u shkatërruar, sa të mundemi...

— Ashtu si punon ti nuk bën — iu kthyje Xhezua duke fshirë me kurrizin e dorës djersën e ballit. Që të pritet pema, sado e vogël qoftë ajo, do fuqi, jo llafe. Pa hë, jepi një herë ti tashti!

Bardhyli si i turpëruar, hoqi këmishën e nisi me sa fuqi që kish, t'u bjerë pemëve. Nga nxitimi nuk vinte re se ku u binte dhe pothuajse nuk po rrëzohej as edhe një gjeth.

— Po jo në mes, a t'u kyqtë! Të prerët me kosore e sidomos kur drurët nuk janë dhe aqë të trashë, e duan mu në rrëzë. Ja shikomë mua dhe një herë.

Si një mësues i mirë, apo si një prind i urtë,

ai e mori përsëri kosoren në dorë e filloj të presë përsëri.

— Oou! Po dhe fuqisë jepi një çikë të shkretën. U ky ore! Ç'pandeh ti, se u bëka puna aqë kollaj, a? Jo or jo! Hë, t'ja dish kimtin druvarit dhe fshatarit.

Vëndi i pastruar në mes të pyllit dukej si një e prerë me gërshërë në kurrizin e një deleje që ja bën bariu ngandonjëherë, për ta dalluar nga të tjerat. Dëgjoheshin dhe sopatat e kosoret e të tjerëve që po na afroheshin neve, por dhe ne po u afroheshim atyre.

— Forca, shokë! Edhe pak e do të bëhet ceremonia e takimit të të dy fronteve, — tha Vasua.

— Jo dy, por pesë! — korigjoi Mersini.

— Do të pimë ahore, — tha përsëri Vasua.

— Jo do të pimë, por do të hamë — thashë unë.

Me të vërtetë do të hamë mëngjesin. Duhet ta kishim ngrënë që më parë, por me që sot na ndodhi puna kështu, do hanim pak më vonë se zakonisht. Deri tashti asnje nuk qe ndjerë për këtë.

— Forca, shokë, se po ankohet ky stomaku im, — tha përsëri Mersini.

— Forca me të vërtetë! — tha dhe Xhezua.

Pas pak u takuam me skuadrën e Ganiut. Si për ceremoni, përplasëm disa herë sopatat me njëra tjetrën. Pak më vonë u takua me ne dhe Shabani me Sotirin. Pastaj u ulëm të hamë mëngjesin tërë oreks.

— Këtij i thonë të ngrënë, hë! — s'i rrihej pa folur Vasos, — pa ardhur në aksion e besoni apo nuk e besoni, s'kam patur oreks fare.

— More, po e hamë vonë mëngjesin e mos na presë oreksin e drekës...

— Megjithë mënd e ke ti, apo ashtu të erdhi e fole?! Ohu; ma jep mua racionin ti! — s'pushonte Vasua.

— Hë se gatuan mirë xha Jani. Mua më duket se këtu po na i bën më të mira gjellët se në konvikt, megjithë kushtet e vështira që kemi — tha Xhezua.

— Jo a derëzi; por të duken të tilla se lodhesh. A të kujtohet se si i bënин të shijshme gjellët romakët, me anën e oreksit, — tha Xhemali.

Qeshëm të gjithë me të madhe.

— Hë se na mbyte, or shejtan! — tha Neta duke mbajtur me zor të qeshurit.


— Kur çlodhesh ca, e ke shumë të vështirë pastaj sa të fillosh përsëri punën, — tha Sotiri që hëngri bukë pranë meje, — unë ndaj s'para ulem zakonisht.

— Ashtu është me të vërtetë. Dhe unë më tepër më këmbë i kaloj pushimet, — shtoi Xhezua.

— Ashtu është! — ja ktheva dhe unë, por si të mësohesh.

— Çohuni shokë, se vendi nuk na thotë kurre çohuni, apo jo Gani? — tha Meisini dhe filloi të qeshte vetë i pari, duke u çuar nga vendi.

— Hë dreq, o dreq, këto vë re ti, nuk shikon punën — ja ktheu Gani duke u çuar dhe ai e si mori kosoren, bëri tutje. Pas tij u çuam me radhë edhe ne të tjerët.



Kapitulli i tretë

— Shokë vullnetarë, mirëmëngjesi!
Të gjithë me mëndje ja kthyem përshëndet-
jen spikerit të radios.

— Shokë vullnetarë! Ora tre. Çohuni!
Thirrja e dytë nuk qe si e para. Filluan lë-
vizjet. Akoma nuk i dalloje dot, me që s'po ngri-
hej njeri. Me siguri tashti Ganiu po fërkonte sy-
të. Ja dhe pak dhe ai do të çohej. Ngrihej gjith-
monë i pari e pastaj fillonte të na zgjonte edhe
ne të tjerëve.

— Ora tre e pesë! Çohuni, shokë!
U mata të çohesha. Ngrita pak kokën, por në
vënd që t'i jepja dhe trupit dhe të ngrihesha, ra-
shë në krahun tjetër. Zgjimin e kishim shumë të
vështirë. Kjo ndodhë edhe më të tjerët. Do të
dëshironim të qëndronim edhe një orë ose dy
mbas punës, por vetëm të na linin tanë në mën-
gjes edhe pak më tepër, qoftë edhe disa minuta.

— Shokë vullnetarë! Ora tre e dhjetë, çohu-
ni pra!

Bëra përpjekjen e dytë. U ngrita përgjysmë.
Sytë gjithmonë të mbyllur. Ehë, ata s'i hapje dot.
Sikur të ishin ngjitur me kushedi se çfarë lloj
ngjitetësi të fortë. Ja, doje t'i hapja, por më kot.
Nuk më bindeshin. Më pëlqente të shtrihesha dhe
pak, qoftë dhe pesë minuta. Dhe u shtriva. Shkoi
kështu dhe përpjekja e dytë kot.

— Shokë vullnetarë! Ora shkoi tre e një çe-
rek. Asnjë nuk po çohet. Çohuni pra, lahuni dhe
bëhuni gati pér punë!

Mbrëmë më zuri gjumi vonë. Ishte dhe kjo
një nga arësyet që nuk po mundja të ngrihesha. E

ndjenja se të tjerët po ngriheshin. Ja, Xhezua që kisha afër, ngrihej gjithmonë me të parët. Atë kurrë nuk e zgjonte Ganiu. Zgjohej vetë. Dhe mua zakonisht më delte gjumi. Rrallë më duhej ndihma e Ganiut. Por sot po më ndodhte si ditën e parë. U ngrita përsëri përgjysmë. Sytë të mbyllur. I hapa pak duke mobilizuar për këtë gjithë forcat, por në çast u mbyllën përsëri. Nuk qe punë. Ra-shë përsëri pa e kuptuar as vetë.

— Çohu, çohu se vajti vonë! — ndjeva një dorë që po më përkundte si djepin e një fëmije. E njoha edhe nga zëri edhe nga dora: ishte Ganiu.

— Do të çohem, Gani, po zgjo të tjerët! Ja u ngrita!

Dhe u ngrita vërtet. Mobilizova gjithë fuqitë e ja më në fund u ndodha më këmbë. Me sy, si gjithmonë, fare të mbyllur, mora pantallonat e nisa t'i vesh. Akoma nuk isha ndarë me gjumin. Ishin çastet e fundit të përleshjes me të. U vesha. Mora gavetën me ujë e u bëra gati të dal jashtë. U përplasa me një tjetër.

— Oou! Më fal!

Kuptova se sytë s'i kisha hapur akoma. Ah, ç'po më mundonte dhe ky gjumi. Spikeri vazhdonte thirrjet e tij çdo pesë minuta, apo ndofta edhe më shpesh. Tashti kish shkuar në vënd të tij një nga studentët. E njoha nga zëri. Po recitonë një rubai të Omar Khajamit:

Zgjohu! Mëngjezi me shigjeta e grisi,
Perden e natës, yjtë i arratisi,
Dhe dielli gjahtar me rreze kapi,
Çdo majë mal i pallati e lisi!

Nëpër tenda dëgjoheshin të qeshura. Kështu ndodhët shpesh herë. Qe Ademi, i një kursi parallel me ne. Nuk mbaj mend ndonjë mbrëmje ose mbledhje përkujtimore që ai të mos recitonte poezi. I kish bërë monopol. Herë-herë edhe recitonte mirë, por më shpesh na mërziste. Ndofta nga që e dëgjonim aqë dëndur. Ai e hiqte veten për njeri me talent. Na vinte keq për të, që nuk e kuptonte se kur fliste aq shumë për veten e tij bëhej qesharak.

— Na, hidhmë një çikë ujë! — më tha Rexhepi — s'po më del gjumi akoma, e kam keq!

— Mësohu t'i shërbesh vetvetes! — i thashë unë e i hodha.

— Jo mo, unë s'para lahem fare mëngjeseve, por sot se si m'u shkrep.

— Kurse unë nuk rri dot pa u larë, — i thashë, — që i vogël nuk mbaj mënd të më ketë kaluar edhe një mëngjes pa u larë. E kam si ligj.

Dola në shesh. Tani duhet të prisnim, sa të çoheshim të gjithë, për të dëgjuar urdhërin e ditës. Kjo s'para na pëlqente e na mërziste ne që çoheshim në rregull. Diç më ra ndër mend:

— Shaban — i thashë me që e gjeta dhe atë pak si të mërzitur. — Shkojmë drejt e në punë, se dhe me normë dje s'dolëm aqë mirë! Kishim mundësi për më shumë.

Ai në fillim nuk po përgjigjëj. Pastaj tha si me zor:

— Po mos na thonë gjë, pa dhe unë jam da-kord.

U nisëm. Ishte ende errësirë. Kish dhe të tje-

rë që vepronin kështu si ne. Kjo nuk më pëlqeu nga njëra anë se thyhej disiplina. «Për një e pér dy — vazhdoja unë arësyetimin — nuk bëhet gjë». Ja thashë Shabanit dhe këtë.

— Jo, unë nuk jam me ty — tha ai — si një e dy, si njëqind; thyerje discipline është. Nuk duhet të shkonim por... hajde s'ka gjë. Për të mirën e shoqërisë e bëjmë, se të qe pér mua, normën e bëj që në dy orët e para.

Ashtu ishte vërtet. Punonte sa pér katër. M'u kujtua dita e tretë, kur sapo kishim filluar të hapnim taraca. E kishim ca të vështirë se nuk ishim mësuar. Ky po punonte vetëm në një qoshe me kazmë e me lopatë. Kishim front pune të gjerë se disa merreshin dhe me çpyllëzim. Në fund do të bëhej matja. Aty ndodhi çudia. Të tjerët me zor kishin realizuar normën. Kish dhe nga ata, që nuk e kishin realizuar dot. Në fund i erdhi radha Shabanit. Me që ishte dita e parë, Ganiun e Shabanin që po matnin, i ndiqnin pas të gjithë. Taraca e Shabanit na habiti të gjithëve. Na u duk shumë e madhe. E matëm. Ganiu bëri shpejt e shpejt llogarinë. Unë isha pas tij e po e ndiqja me vëmëndje majën e lapsit kopjativ. Si nxori rezultatin, kruajti me bishtin e lapsit ballin e po mendohej. Shifra doli shumë e madhe. Mos e kish bërë gabim?! I përsëriti dhe një herë llogaritjet. Të gjithë po prisin plot ankth.

— Po hë de të shkretën, se na nxore shpirtin — s'i durohej Vasos.

— Ama jo de! Sikur ç'ka pér të bërë!? S'e ke fajin ti, po ai që të ka kaluar në matematikë, — ja mbante më krahun tjetër Rexhepi.

Ganiu nuk i vinte re. Si mbaroi, filloj të kruante përsëri ballin me bishtin e lapsit.

— Dymbëdhjetë metra! — i tha normistit me zë të ulët për të mos e dëgjuar të tjerët. Unë e dëgjova, ndonse dhe rezultatin e pashë. Dhe mua si kur nuk më besohej.

— Sa njerëz kanë punuar këtu? — pyeti normisti, ndonse që në fillim Ganiu i kish thënë se që vetëm një njeri.

— Një vetëm?!

— Nuk ka mundësi! Do ta kemi matur gabim. E masim dhe njëherë!

— E masim! — aprovoi Ganiu.

Unë po heshtja, ndonse isha i sigurtë se matja e llogaritja ishin bërë në rregull. Por dhe ta kundërshtoja nuk guxoja, se shifra m'u duk shumë e madhe. I thoshin katër norma e ca. Dhe që ditën e parë.

Normisti i ndërmarrjes e kish zakon, siç duket, për të qenë brënda, që metrin e mbante disa centimetra më pak. Kjo na mundonte të gjithëve, por kur mendonim se puna nuk na humbiste me që në fund kishin për t'u bërë matjet e përgjithëshme, nuk ngulnim shumë këmbë. Tani, kur po bëhej matja e dytë e Shabanit, tek metri i tij ishin ngulur dhjetra sy e ai nuk guxonë të bënte sipas zakonit. Ndërsa po ndodhnin gjithë këto, Shabani as që po e çante kokën. Kur i hodha një sy, më habit i gjakftohtësia e tij, sikur të qe i sigurtë se do të ndodhte ashtu. Po bisedonte pa e prishur gjakun me një vajzë të kompanisë tjetër.

U bë matja e dytë. Habia qe më e madhe. Llogaritë i bëri vetë normisti. I kontrolloi dhe

një herë shpejt e shpejt dhe tha me zë të lartë që ta dëgjonin të gjithë:

— Dymbëdhjetë e një çerek! Afro pesë norma!

Shpërthyen duartrokitje e urra të forta sa e dëgjuan dhe ata të brigadave të tjera. Disa, më çapkënët, shkuan tek Shabani, e kapën dhe e ngritën lart. Me ta u bashkuan dhe të tjerë dhe nisën ta hedhin «hopa» në ajër. Shabani në fillim nisi të kundërshtonte, e u thosh tërë inat sikur ta kapnin për ta rrahu:

— Ç'bëni, or ç'bëni kështu! Lermëni ore rehat! — e u çua të bënte më tej duke i shtyrë me duar. Por ata e kapën dhe e ngritën. Ai vazhdon të ankohej, deri sa më në fund u buzëqeshi si me zor. Ceremonia vazhdoi gjatë. Rrugën, për t'u kthyer, atë ditë e bëmë bashkë.

— More, po ti nuk po e prishje gjakun fare, — i thashë unë, — më habite së tepërm, s'të dija aqë gjakftohtë!

— Hë, po unë e dija a derëbardhë, — më tha, — në fshat ma kanë zili gjithë për qilizmë. Pastaj kisha dhe vëndin të mirë; kisha naltësi! Dhe toka qe e mirë, e butë si bukëvale...

— Po këto i kishin të gjithë — i thashë unë, duke e vështruar me dashuri. Duart e tija të më-dha e të ashpra flisnin më tepër se çdo gjë si për të vërtetuar ato që thosh. Qysh atë ditë ne nuk habiteshim më me të, sado që ta tejkalonte normën. Skuadra e tij, gjithmonë zinte vëndin e parë.

Errësira e natës nuk qe larguar akoma e qe

aqë e madhe, sa nuk po e dalloja dot mirë fytyrën e Shabanit kur m'u kujtuan gjithë këto. Kështu na ndodhët shpesh herë. Mund të bëje rru-gëng me shokun tënd të afërt, deri tek vëndi i punës, pa e njohur fare, e vetëm atje i thoshim njëri tjetrit:

— Uua, ti qënke! s'të pashë fare!

Mund t'i dalloje vetëm siluetën. E njihje tjetrin nga fjalët në se do të bënin muhabet. Por zakonisht, me që nuk na kish dalë akoma mirë gjumi, ecnim pa folur.

Arritëm tek vendi i punës. Vumë re se dikush kish ardhur para nesh e kish filluar nga puna.

— Xhezo, ti qënke?! — i thamë.

— Unë kështu e bëj zakonisht, — tha ai, — urdhërin e ditës ma transmetojnë të tjerët.

Filluam të punojmë dhe ne. Kur erdhën të tjerët, me që vinin të shkëputur, nuk e morën vesh punën tonë. Kjo na pëlqeu dhe e bëmë edhe të nesërmen. Kështu pak nga pak na u bë zakon. Por nuk u shqetsuam gjatë për këtë «thyerje të disiplinës». Me mendimin tonë erdhën e u bashkuan edhe ata të shtabit. Kështu filluan të na e thoshin që në darkë urdhërin e ditës. Në mëngjes bëhej vetëm ceremonia e ngritjes së flamurit, e pastaj niseshim për në punë.

Kapitulli i katërt

Ne ktheheshim nga puna të lodhur e, ai si me magji na e hijte gjithë lodhjen. Bëheshim në punë pis. Jo rrallë qëllonte që nga fytyra e nga



trupi mos ta njihje fare tjetrin e, ai na pastronte si një amvisë e mirë. Ndodhte shpesh që gjatë punës gërvishnim duart apo këmbët, fytyrën apo trupin. Rrallë edhe gjakoseshim. Gjithë këto, ai me kujdes pa e ndjerë fare, si një doktor çudibërrës na i mjekonte. Kish raste që mërziteshim, siç ndodhë zakonisht kur nuk na pëlqente përqindja e normës dhe ai na e hiqte gjithë mërzinë, na gjallëronte. Dhe ne e donim pa masë, që të gjithë. Tek ai i drejtonim sytë vazhdimisht gjatë ditës.

Ky ishte deti!

Ktheheshim tek ai të gjithë menjëherë mbas punës. Bregu mbushej me trupat e xhveshur ngjyrë bronxi, e, në ato çaste na dukej se ishim nëndonjë shtëpi pushimi, në plazh. Të gjithë i shihje ose në breg, ose në ujë.

Edhe këtu ne laheshim zakonisht gjithë studentët e kursit së bashku e kjo kish arësyet e veta. Para së gjithash kishim vendosur që notin ta mësonim të gjithë mirë. Ata që nuk dinin i morëm ne të tjerët në patronazh. Mua më ra Xhemali. Tregohej ca i ngathët. Dilte më tepër i zoti në teori, se sa në praktikë edhe në mësimin e notit. Kur ishim në breg, i dëgjonte me vëmendje udhëzimet e mia, bënte pyetje e betohej e stërbe tohej se sapo të futej në det, nuk do të kish frikë, po do të hynte thellë.

— Po ndryshe është e kotë, — i thosha unë, — aty ku futesh ti, nuk mësohet noti.

— Mirë, do të futem — thosh — kur të thuash ti! Ja, hajde që tashti po deshe!

Dhe hynte në det. Pas tij hyja dhe unë. Nuk ja prishja qefin. Por në çast gjithë premtimet me fjalë të mëdha, shkriheshin si shkumba e dallgëve

në breg të detit. I hynte frika. Bërtiste. Donte të kthehej, por unë nuk e lija.

— Hë, futu, futu, se s'të gjen gjël! — i thosha. Kthehej përsëri pa qef. Kémbët nuk i ngrinte fare. Kish shumë frikë. Ja kapja e i jepja të shtymën drejt thellësisë. Fundosej. Pinte ujë e nxehjej. Ndodhje që edhe më shante tërë inat.

Ktheheshim përsëri në breg. Pak nga pak i binte inati. Filloja përsëri udhëzimet. Binte da-kord me mua pér çdo gjë. Kur e dëgjoje tashti, nuk të besohej se ishte po ai Xhemali i detit që qe nxehur aqë fort pak më parë. Pastaj merrte zjarr si më parë, e nuk vononte e futeshim përsëri. Kjo vazhdoi më tepër se një javë. Tashti kish mësuar të ecte, por nuk qëndronte shumë. Nxënesi im nuk po përparonte sic duhej. Të tjerët kishin mësuar më mirë e unë pér këtë haja inat me veten time dhe me Xhemalin.

Ganiu kish marr në patronazh Shabanin. Ai nuk e lodhi aqë shumë. Edhe në det, si në taraca, tregohej i fortë, i durueshëm e i guximshëm. Kur e shihje tek notonte vetëm dy javë mbasi kish filluar të mësonte, nuk e dalloje dot as nga ne të tjerët. Ne mund t'ja kalonim atij vetëm në stile të ndryshme, që ai nuk merrte vesh, por kjo nuk e shqetësonte shumë.

— E or e, të di not që të mos mytem unë, pa llustrat i mësoj mbrapa — na thosh se herë që e ngacmonim me shaka.

Mua më pëlqente të futesha thellë e të ha-hesha në ecje me Mujon dhe me Sandrin. Më i shkathët nga ne ishte Sandri, por më i shpejtë Mujua. Sandri binte në sy më tepër pér numu-

rat që bënte. Nuk pinte ujë, sado që të mundo-heshe ta fundosje, qoftë edhe papritur. Unë as nuk kërkoja të hyja në garë me të. Shpesh ma kish prishur qefin se kur çlodhesha më kurriz, vinte papandehur dhe më fuste kokën në ujë. Më ngacmonin dhe të tjerët se e dinin që nuk nxehesha dhe s'ua merrja për të keq. Rrallë që-llonte që të mos pija ujë fare, sa herë futesha në det.

Në breg grumbulloheshim kokë më kokë e ja fillonim bisedës gjithë humor. Një herë zumë një bisedë interesante me profesor Veliun. Si-kur s'të besohej, kur e shihje tek queshte e kuvëndonte me ne, që të ishte po ai që në provimin e qershorit, vetëm një muaj më parë, kish lënë afro gjysmën e klasës. Atë kohë Mersini u ngrit nga vendi e tha:

— Unë po shkoj të lahem.

— Hë, ç'folje është në këtë rast «lahem»? — pyeti Vasua duke na shkelur synë neve dhe profesorit.

— Vetvetore e mirëfilltë, — u përgjegj në çast Mersini duke qeshur.

— Jo, këtu nuk është e mirëfilltë, — ja ktheu Vasua i vendosur.

— Si mor nuk është e mirëfilltë, por kjo ësh-të e para në shembujt e tekstit...

— More po le të jetë daç e para, daç e fundit, për këtë jam i sigurtë se nuk është vetvetore, se merret në kuptimin e foljes «eci», pra...

— Ti do të thuash se është intranzitive? — tha Mersini pak si i nxehur.

— Jo dua të them, por ashtu është, apo jo,

profesor? Më vjen keq se ke marrë dhe provimin.

— Po, po! Ka të drejtë Vasua, — tha profesori.

— Ja, u duk dhe këtu se kush e meritonte të kalonte dhe kush jo — tha përsëri Vasua duke na shkelur përsëri synë. Mersini nuk foli më, por u fut në det. Të gjithë e shikonim e qeshnim. Pastaj biseda jonë u përqëndrua tek aksioni.